



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0022173/24 dt. 28.03.2024
Mitrovicë

Në zbatim të nenit 43, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës; nenit 50, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 52, paragrafi 1, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; Kryesuesja e Kuvendit të Komunës për të **hënë**n më dt. **08.04.2024**:

T H Ë R R E T
Mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës
Seanca e 30-të

Mbledhja do të ketë këtë:

REND DITE:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Draft-Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 02/2019 Për taksa, tarifa dhe gjoha komunale
3. Kërkesë për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Mitrovicës
4. Kërkesa e Sindikatës së të Punësuarve në Komunën e Mitrovicës për mbështetje financiare
5. Pyetje dhe përgjigje

Mbledhja do të mbahet në Sallën e Kuvendit duke filluar nga ora 10:00.

Mitrovicë



Kryesuesja e Kuvendit

Vesa BROJA



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0015247-1/24 dt. 31.01.2024
Mitrovicë

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e 29-të e rregullt e Kuvendit të Komunës

Koha: 12.03.2024 ora 10:00

Vendi: Salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës

Të pranishëm: Anëtarët e Kuvendit: Vesa Broja, Shkëlqim Ibrahim, Fisnik Suma, Majlinda Kurti, Xhafer Preteni, Lavdim Zeneli, Florina Çitaku, Fadil Veseli, Hamdi Hasani, Mentor Vinarci, Nazmije Sejdiu, Fisnik Krasniqi, Egzon Hamza, Nafije Rexha, Hysen Muzliukaj, Kushtrim Zeneli, Naser Muja, Jeton Zeneli, Armend Begu, Ekrem Sadiku, Shkurta Shosholli Musa, Erseka Barani, Elidiana Budini Haziri, Xhylljeta Imeri, Flutura Beka Kamberaj, Sevdaim Uka, Gazmend Asllani, Muhamed Hoti, Oltion Ahmeti, Jeton Ujkani, Vesel Neziri, Ardita Aliu dhe Gjergj Beka

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza

Nënkryetari i Komunës z. Arian Tahiri

Drejtorët e Drejtorive

Përfaqësues të Shoqërisë Civile

Mediat

Mungoi: Fisnik Krasniqi, Faruk Mujka, Sevdaim Uka, Shkurta Shosholli Musa dhe Xhevrije Bahtiri Ademi

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesja Kuvendit znj. Vesa Broja, e cila fillimisht përshëndeti Kryetarin e Komunës, anëtarët e Kuvendit, mediat dhe të pranishmit tjerë. Kryesuesja Kuvendit në vazhdim theksoi se zbatim të nenit 43, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 3, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, dhe nenit 5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës; nenit 50, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, dhe nenit 52, paragrafi 1, të Statutit të Komunës ka thirrur mbledhjen e 29-të të rregullt të Kuvendit të Komunës me rendin e ditës të paraparë me thirrje.

Hap diskutimin.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Përshëndetje për të gjithë juve! Më lejoni që edhe unë t'ju uroj muajin e shenjtë të Ramazanit juve dhe të gjithë qytetarëve të Mitrovicës. E kam një lutje, pasi që kam një takim në Prishtinë, nëse ka mundësi që pika katër e rendit të ditës të zhvendoset dhe të jetë pika e dytë e rendit të ditës.

Kryesuesja znj. Vesa Broja: Atëherë pika e katërt e rendit të ditës: Plani i punës së kryetarit të Komunës për vitin 2024 të zhvendoset si pikë e dytë e rendit të ditës dhe pikat e rendit të ditës mbesin të njëjta.

Ekrem Sadiku: Përshëndetje për gjithë, kam një propozim për një pikë të rendit të ditës, seancat e kaluara kemi diskutuar së paku nja dy herë në lidhje me mos kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet për disa familje, është fjala për vitin e kaluar. Andaj unë sot pas

konsultave të cilat kam pas me disa nga asamblistët, përfshi këto edhe asamblistët e PDK-së, kam ardhur me një propozim, ku t'i ndajmë disa mjete për këto familje, edhe pse unë paraprakisht dhe pjesa dërmuese e asamblistëve këtu kemi pritur që do të na vijë një raport prej komisionit për me pa se çka ka ndodhë me ato familje, e cila ka qenë vlerë e dëmit dhe pse nuk janë kompensuar. Mirëpo këtë ne nuk e kemi pranuar, prandaj sot kërkoj që bashkërisht të ndajmë një shumë solide për ta dhe kështu që t'ju dalim në ndihmë atyre, për shkak se si ne nuk po e dimë se çka ka ndodhur, vetëm e dimë se kanë mbetur anash edhe pse kanë qenë të dëmtuar nga vërshimet.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Do të thotë qysh ju jeni e keni këtë informacion, po ashtu edhe unë kam një informacion që disa familje kanë mbetur pa u kompensuar. Ne e dimë që është vendim prej asamblesë komunale që niveli i kompensimit për secilën familje që ka pësua nga vërshimet të jetë në nivel të 2.500€ Vetëm proceduralisht do të thotë, a mundet me krye komisioni i kaluar këtë punë sepse besoj që të gjithë na jemi të interesuar që çdo familje që ka pësua nga vërshime të jetë e kompensuar. Nuk kemi nevojë kur është kompensua pjesa dërmuese e tyre dhe disa prej tyre të mbesin pa të drejtë pa u kompensuar. Po ashtu edhe komisioni të vie me një vlerësim të ri në Kuvend, që këto janë familje të cilat kanë ngelë të pa kompensuara dhe propozohet edhe të merret vendim për kompensimin e këtyre familjeve, lartësia duhet me qenë e njëjtë, se s'mundem me bo dallime. Sa i përket mjeteve, sigurisht se ne kemi mundësi financiare me modelua zgjidhjet e pranueshme për këtë punë edhe me u bë kompensimi i tyre. Mirëpo mendoj që duhet të krijohet një komision, i cili e bën verifikimin e numrit dhe të familjeve, të cilat kanë mbetur të pa kompensuar dhe ky do të jetë një raport i atij komisioni. Por nëse ka dikush ndonjë propozim pak ma ndryshe, le të na e thotë pse jo?

Ekrem Sadiku: Natyrisht që unë në parim pajtohem, dhe për këtë edhe kemi kërkuar që kjo të jetë si procedurë fillestare që mos të bëjmë ndonjë gabim në procedura, dhe që mandej të na e kthej MAPL dhe të mos bëhet asgjë. Por unë çka po kërkoj prej juve kryesueses dhe prej ekzekutivit është që të merret një hap tutje dhe të shohim se cilat janë modalitetet, ndoshta ka mundësi që të krijohet një tjetër komision, apo edhe Zyra Ligjore në kuadër të ekzekutivit, e cila mund të na japë një sqarim.

Kryesuesja znj. Vesa Broja: Unë po besoj që është çështje e kryetarit dhe ekzekutivit formimi i komisionit të ri, po ashtu edhe verifikimi me komisionin e kaluar se a janë kompensuar, dhe pse s'janë të kompensuar ata persona të cilët është dashtë të kompensohen. Po ja kalojmë fjalën drejtorit për një sqarim.

Bahtir Maxhuni: Është e vërtetë që disa qytetarë kanë mbetur pa u kompensuar për dëmet nga vërshimet, për të hy në zanafillë dhe të tregojmë se pse kanë mbetur pa u kompensuar, z. Sadiku, por nëse dikush dëshiron mundet me ardhë në zyrë tek unë edhe komisionin do ta thërrasim dhe do ta sqarojmë saktë. Nuk mendoj se ka nevojë të formohet komisioni i ri, por komisioni i cili është dalë në teren dhe do të bëjnë një rivlerësim për arsye se ngjarjet në teren kanë ndryshuar, dhe se arsyeja kryesore është se kërkesat i kanë bërë me vonesë. Kam qenë në kontakt me qytetarët, po ashtu në zyre i kam pasur disa herë në takime dhe jemi dakorduar që ne do të jua bëjmë zgjidhjen gjithë secilit. E lehtë nuk është, sepse kanë kaluar listat është bërë vlerësimi dhe prap rivlerësimi i dokumentacionit shtesë për tu kompensuar. Mirëpo kryetar, na do të mundohemi ne që ta bëjmë kompensimin e tyre duke mos i kaluar formalitetet ligjore.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Po është situata e qartë, domethënë e krijojmë një komision ose komisionin paraprak, vjen me listë të verifikuar. Nuk është qëllimi askujt që me e shti dikën që me u kompensua nëse s'ka pësua dëmtime, po nuk është qëllimi as i asamblesë as i joni që me mbet dikush i pa kompensuar, nëse ka qenë i dëmtuar. Prandaj, komisioni do ta bën verifikimin e atyre që pretendohen se kanë qenë të dëmtuar dhe nuk janë kompensua, dhe pastaj prej Drejtorisë për Mirëqenie Sociale do të bëhet kompensimi i gjithë atyre familjeve, të cilat potencialisht janë dëmtuar, po nuk janë kompensua.

Hysen Muzliukaj: Tema është nëse po kuptoj kështu, 200 familje janë votuar për të ju dalë në ndihmë me nga 2.500€ Në seancën e fundit e kemi pas një raport të kryetarit, raportin financiar që s'u përshtatke pagesa e këtyre familjeve a kemi të bëjmë me ato familje, që kanë qenë në këtë listë e nuk janë paguar. Pra mua më intereson drejtor a kemi të bëjmë me këto familje që kanë qenë në listë e nuk janë paguar dhe nëse është ashtu ne kemi votuar një listë në kuvend që kanë qenë familjet. Edhe keni prurë një raport vlerësimi të dëmeve. Çka ka ndodhë tash çka ndryshua tek ky raport i vlerësimit? Nëse ju vetë si komision, e keni bërë vlerësimin e atyre të dëmeve, pse s'janë pagua nëse veç janë ardhur këtu në kuvend dhe janë vlerësuar që janë dëmet. Tash edhe nuk di çka do të themi se gjendja në teren ka ndryshuar nuk mundemi me than se pas një viti gjendja është e njëjtë, por ju e keni prurë vetë këtë raport, jo na.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Familjet, të cilat kanë qenë pjesë e evidencës së raportit, janë kompensua nuk është numri 200 është numri më pak se 200 familje të cilat janë kompensuar. Mirëpo z. Muzliukaj janë disa familje, nuk është numri i madh i tyre, në Iliridë e në Bair për të cilat unë tash po dua të besoj që për arsye shumë objektive, ndoshta edhe çështje të kujdesit të komisionit, të vetë familjeve, që kanë ngelë të pa kompensuar, që është shumë e saktë, a shumë evidente, se nuk mundet një fqinj në mes dy familjeve tjera me qenë dhe ata me qenë të vërshuar e ky në mes jo. Prandaj, le të vijmë me një raport, le të vijmë këtu në Kuvend e diskutojmë nëse të gjithë pajtohem që ky është realiteti, na morëm vendim edhe e kompensojmë. Për pa u siguruar që ka ndodhë dëmi e familja nuk është kompensua, unë sigurisht se jam që kjo punë mos me ndodhë edhe mos me ndodhë kompensimi. Me ndodhë verifikimi, me ndodhë sqarimi i detajshëm pse ka ndodhë që nuk janë përfshi, kur sigurohem që gjithçka është në rregull, gjithçka është korrekte, atëherë e morëm vendimin për me i kompensua.

Ekrem Sadiku: Shqetësimi im është për ato familje, të cilat kanë bërë kërkesë dhe ka shkuar komisioni, i ka verifikuar dhe konstatuar dëmet, vlerën e dëmit, pra nuk jemi duke folur për familjet të cilat nuk kanë bërë kërkesë dhe tek të cilat nuk ka shkuar komisioni. Informatat i kam sepse kam pasur kontakt me pjesën dërmuese dhe kemi diskutuar dhe kjo është çka ata më kanë thënë.

Kryesuesja znj. Vesa Broja: Është e qartë, po besoj që është dhe nuk është çështja që a u kon komisioni, a s'u kon. Çështja është që nuk janë kompensua edhe me ja mundësua kompensimin. Dhe për këtë do ta bëjnë një raport të ri, raporti do të silltet në Kuvend dhe Kuvendi do të vendosë për ndihmën tjetër financiare.

Elidiana Budini-Haziri: Dua të trajtoj një çështje që nëse ka mundësi mundet të futet si pikë të rendit të ditës, ose thjesht ka nevojë për me u diskutua në prani të kryetarit. E dimë që kontrata kolektive e mësimdhënësve ka sjellë obligime për të gjitha komunat, me apo pa dëshirën e tyre. E dimë që nënshkruesit e kontratës ka qenë sindikata e arsimit edhe qeveria, por që komunat pa dashjen e tyre duhet me i mbajtur obligimet financiare. Po ashtu, na është thënë prej avokatëve përfaqësues të mësimdhënësve që është një parakontratë, të paktën që diskutohet ndërmjet komunës dhe avokatëve përfaqësues të mësimdhënësve që obligimet komuna do t'i kryejë pa shkuar nëpër procedura ligjore dhe pa e futur ndërmjet përmbartuesin. Sipas një matematike thjeshtë, i bie që ato pare nuk janë të destinuara, ne duhet t'i marrim diku në ndonjë kod tjetër buxhetor. Pyetja ime është a ekziston vërtet një kontratë marrëveshje ndërmjet avokatëve dhe komunës? Nëse ekziston, ku do të merren ato mjete financiare për t'i kompensuar këta mësimdhënës, sepse shuma sigurisht është e madhe. E nëse nuk është një kontratë e tillë, atëherë bie që duhet përsëri me vazhdo me procedura ligjore dhe përmbartuesit duhet me marrë pjesën e tyre që i takon. Mendoj se është diçka shqetësuese për të gjithë mësimdhënësit dhe është një numër i konsiderueshëm, prandaj po e nxjerr edhe si shqetësim, ose trajtojemi si pikë të rendit të ditës, ose si sqarim qysh të do.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Të them të drejtën Komunat, një pjesë si rezultat i këtyre kontratave, për mu sa i përket aspektit ligjor, gjithmonë kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të dyshimta, sepse çdo dokument, i cili ka ndikim buxhetor, duhet me pas deklaraten edhe vlerësimin

për ndikimin buxhetor. As që shqetësohem se kush i ka nënshkruar, kushdo qoftë dhe i cilës do parti politike që ka qenë, po. i ka nënshkruar niveli qendror, mirëpo faktikisht po del që ka prodhuar obligim për nivelin lokal, për komunat dhe nuk po flasim për shumat e vogla, por po flasim për miliona, vetëm prej se e kam filluar këtë mandat. E le tjerat! Kurrë s'po kanë mbarim, veç po vijnë herë për një arsye, herë për një arsye tjetër edhe po e ndikojnë buxhetin, po e ndikojnë edhe strukturën e buxhetit, sepse nuk mundën me i planifikua te pagat, sepse kur e merr qarkoren buxhetore, ty të vijnë edhe kufijtë dhe nuk mundesh me planifikua më shumë të pagat sesa që t'i ka dërgu MF-ja. Është një obligim që realisht nëse nuk arrijmë me e shmang koston e procedurave gjyqësore mundet me i tejkalua pesë milionë euro. Qëllimi është që të paktën me i shmang procedurat përmbartimore dhe koston përmbartimore, ndërsa njerëzit, në këtë rast personeli arsimor me u kompensuar. Prapëseprapë duhet me shku me procedurë gjyqësore me marrëveshje, përndryshe nuk mundën me hy në listë të pagave pa e pasur një vendim. se s'është pagë e rregullt, është pagë që kalohet përmes procedurave gjyqësore. Jemi të interesuar me përfundua këtë sa më shpejt, pra jemi të interesuar që këtë kompensim me e përmbush brenda këtij viti fiskal. Qëllimi ka qenë që pjesa e parë të përfundohet gjatë muajit mars, a do të arrijmë mbetet me pa, po kjo është objektivi, këto janë afatet dhe pjesën tjetër qysh kemi negociuar domethënë ka pjesa e dytë e vitit. Përndryshe, ky është obligim, në një mënyrë a në tjetrën njerëzit kanë me i marrë kompensimet e tyre, mirëpo nëse s'shkon në grup, ata disa kanë me i marrë sivjet, disa vitin e ardhshëm dhe disa në vitet vijuese, se nuk mundën që të gjithë përnjëherë me ardh në rend në gjykatë edhe kosto ka me u rritë, po edhe arsimtarët kanë me i marrë paratë e tyre me vonesë. Prandaj, është mirë për personelin arsimor që me i marrë këtë vit pjesën e atyre që u takon, për Komunën është tepër mirë me i zvogëluar shpenzimet e përmbartimit edhe të avokatëve dhe sigurisht se ka me ndiku edhe strukturën e buxhetit, se një pjesë e tyre ndoshta arrin me u zbatua dhe ekzekutu prej pozicionit të pagave, por është e mundshme që ndërhyt edhe te pjesa e investimeve kapitale edhe t'i sakrifikon disa projekte, sigurisht ku është urdhër përmbartimor, thesari veç të pyet, a po më tregon ku me t'i marr mjetet, nëse ti nuk i përgjigjesh, i merr vetë. Kështu që kjo është situata profesionale. Unë e kuptoj është e drejtë ligjore e keni fituar këtë të drejtë. Kur e kanë nënshkruar kontratën është deshtë me qenë ata që me e mbulua edhe koston, mirëpo nuk ka ndodhë, keni pritë me vite dhe unë jam duke punuar dhe jam shumë ithtar e përkrahës i asaj që sa më shpejtë të kryhet ky obligim, përndryshe Komuna e ka në derë! Është e pashmangshme.

Kushtrim Zeneli: Meqenëse muaji Mars njihet si muaj i nënave dhe vajzave atëherë unë kam një propozim për gratë dhe vajzat ose më mirë me thënë për Nënën vetë-ushqyese, Propozimi im konkret është subvencionimi me çerdhen private dhe lirim nga pagesa në çerdhen publike për nënat vetë-ushqyese. Pra, nuk mundem me vazhdua me qenë spektatorë në sfidat e grave dhe sidomos ndaj grave që kanë dhunë në familje dhe nënave vetë-ushqyese.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Sigurisht se kanë nevojë për përkrahje kjo kategori, po për me ndodhë kjo, na duhet me pas disa elemente. Ne duhet të dimë se sa është numri i tyre, sa është numri i fëmijëve, sa prej tyre shkojnë në çerdhe publike, sa në çerdhe private, sa është kostoja totale e kësaj pune dhe duhet me e pritë vitin e ardhshëm buxhetor që me bë pjesë buxhetit. Përndryshe, në konsideratë po e marrim, për procedurat e ardhshme, sepse tash ne mundemi me marrë vendim, por për me ekzekutua nuk kemi ku me i ekzekutua, sepse nuk janë të ndara mjetet për këtë destinim. Pra për procedurat e ardhshme dhe për vitet e ardhshme buxhetore, kur te dimë koston e shohim mundësinë, se edhe unë po ashtu jam ithtar i asaj që realisht të gjitha ato nëna, të cilat kujdesen për fëmijët e tyre dhe është barrë e madhe me i rritë fëmijët vetëm jam i interesuar me diskutua dhe me pas konsideratë. Mirëpo është mirë, jo vetëm me thënë "po e bëjmë këtë" pa i ditë këto elemente.

Drita Kadriu: Veç se për informim për z. Zeneli, që Udhëzimi për çerdhet publike i ka të rregulluara lirimet nga pagesa për disa kategori, ku në ato kategori bëjnë pjesë edhe nënat vetushqyese.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Atëherë në bazë të sqarimit që na e dha drejtoresha po kuptohet që do ta kemi më të lehtë, për shkak se realisht është ardhë edhe fundi me u përfundua edhe po besoj që në shtator me fillua edhe Çerdhen në Shipol edhe ndërtimin buxhet që keni votua janë ndërtimi i disa çerdheve dhe kjo e lehtëson, koston edhe për komunën edhe është diçka e përballueshme.

Kushtrim Zeneli: Atëherë a mundemi për në seancën e ardhshme me na e sjell një raport, se sigurisht këto të dhëna që u theksuan drejtoria e Mirëqenies Sociale me pas një raport sa më të saktë për nënat vetushqyese, gratë e fëmijët.

Erseka Barani: Unë kam një propozim konkret, të gjithë jemi dëshmitarë se sa është rritë numri i rasteve të kësaj dukurie negative të dhunës në familje. Ky propozim që dua të bëj, faktikisht ka pikërisht të bëj me viktimat e dhunës në familje që lehtësisht janë të evidentueshme edhe nga Drejtoria e Mirëqenies Sociale. Ato viktimat janë në objektin e “Raba Voca”, objekt i cili nuk i përmbush as kriteret esenciale për një jetesë, duke e ditë që viktimat e dhunës shkojnë aty bashkë me fëmijët e tyre dhe jo të vetme, kështu që mendoj që ju duhen kushte më të favorshme, që ata fëmijë të paktën ta kenë atë përjetim më të lehtë. Kërkoj nga ju dhe nga ekzekutivi, po ashtu kërkoj mbështetjen nga gjithë asamblistët që këto raste viktimat e dhunës në familje, meqenëse jemi edhe para kalimit të të hyrave vetanake të vitit të kaluar, lehtësisht mund të kemi një evidencë dhe t'i përkrahim ato viktimat të dhunës në familje me pagesë të qerasë. Kjo nuk besoj që do ta rëndonte buxhetin e komunës me të vetmin fakt se ato janë aty për një periudhë të shkurtë dhe jo për një periudhë të gjatë, derisa të bëjmë zgjidhje të përhershme. Kështu që mendoj që në bazë të statistikave dhe lehtësisht është një mekanizëm në kuadër të komunës që e dinë saktësisht se sa viktimat janë, ku përfshihen edhe policia, përfshihet drejtoria e arsimit, drejtoria e Shëndetësisë edhe kabineti i kryetarit. Kështu që mendoj se para se të bëhet kjo, të ndahet një shumë dhe ta dimë për afërsisht një numër nga drejtoria e MS se sa viktimat të dhunës në familje janë dhe mendoj që lehtësimi i kësaj gjendje, të paktën në këtë aspekt, do të lehtësonte shumë jetesën e atyre grave, atyre viktimave dhe fëmijëve të cilët e kanë me të vërtetë nevojë edhe për përkrahjen nga niveli komunal.

Kryetari Komunës z. Bedri Hamza: Besoj se jeni në dijeni se jemi tu e ndërtua objektin e ri për këtë qëllim dhe besoj që gjatë këtij viti do të jetë në funksion. Besoj që jemi në mesin e komunave të pakta për shkak se ka qenë domosdoshmëri ndërtimi i këtij objekti, siç e potencuat edhe ju për mungesë të kushteve, është edhe goxha e rrezikshme, aty do të jemi i kujdesshëm në formulim aty rrinë bashkë persona të natyrave të ndryshme në të njëjtin objekt dhe kanë ndikim negativ te vajzat dhe djemtë e ri, të cilët, bashkë me nënat ndodhen në atë objekt. Po besoj që këtë vit ky objekt do të përfundon dhe do të ofron kushte korrekte. Sa unë jam në informacion, po besoj që në seancën e ardhshme mundemi me ardh edhe ma saktë na veç i ndihmojmë përmes DMS-së dhe gjithmonë jemi në mbështetje të kësaj kategorie të rrezikuar dhe mjaft të ndjeshme. Po mbi të gjitha është tepër e rëndësishëm që sa më shpejt përfundohet objekti dhe këto t'i kenë kushtet dhe trajtimin në përputhje me standardet.

Erseka Barani: A ka mundësi se derisa të përfundohet objekti, të paktën ato që janë tani edhe shpresoj që të mos ketë më dhe të jenë të fundit, të paktën të ketë përkrahje nga komuna për ato derisa të përfundohet objekti. Kryetari e ceku shumë mirë, aty me të vërtetë janë kategori të ndryshme dhe është regjionale, nuk është vetëm e Komunës së Mitrovicës, kështu kemi edhe nga qytete të tjera që vijnë, ndihen të kërcënuara çdo ditë, ndoshta edhe nga dhunuesit, të cilët shkojnë aty në atë objekt. Kështu që mendoj që të paktën një trajtim më të dinjitetshëm edhe një ndihmesë. Unë e di që komuna e Mitrovicës i përkrahë vazhdimisht mirëpo me pagesë të qerasë është një ndihmë konkrete, e cila do t'i ndihmonte jashtëzakonisht shumë viktimat e dhunës në familje konkretisht fëmijët e të cilët e përjetojnë rëndë atë pjesë.

Kryesuesja znj. Vesa Broja: Po besoj që mundemi me u marrë edhe me evidentimin e numrit, të familjeve në fjalë që po diskutojmë edhe pastaj bashkë me Drejtoreshën e Mirëqenies, më i marr

edhe të dhënat konkrete se a ndihmohen në këtë aspekt. Po ashtu edhe unë kam informacionin që familjet që vijnë dhe kanë nevojë për mbështetje për qera, DMS i ndihmon edhe tash, po pasi që nuk është drejtoresha këtu, nuk po mundemi me thënë asgjë për të dhëna të sakta. Kështu që po besoj që është mirë me e lënë deri seancën e ardhshme, të diskutojmë edhe bashkërisht me drejtoreshën, edhe pastaj të vijmë me një propozim konkret, nëse është e nevojshme.

Hysen Muzliukaj: Më intereson të di se a është bërë ndonjë gabim për muajin Janar, ose për muajin Shkurt. Në muajin Janar, me sa e di, s'kena mbajtur mbledhje të KPF-së por na është bërë pagesa e shtesës, ndërsa në muajin Shkurt mbledhje kemi mbajtur por pagesa nuk është bërë. Më intereson të di pse ka ndodhur kjo sepse unë mendoj që nuk është në rregull, se dalim keq tek ndonjë raport i auditimit.

Kryesuesja Vesa Broja: Sa i përket listës për pagesa, lista prej Sekretarisë së Kuvendit, e cila nënshkruhet nga unë, në muajin Janar ka shkuar pa mëditje të KPF-së, ndërkaq Ministria i ka kompensua ato. Muajin shkurt lista ka shkuar me mëditje për mbledhjen që është mbajtur të KPF-së, ndërsa ata e kanë bërë barazimin atje edhe nuk e kanë qitë për shkak se janë marrë në muajin Janar. Edhe e kanë qitë veç diferencën që prej Janarit është dashtë me rritje 110 koeficienti, ndërsa në Janar i kanë qitë më të vitit të kaluar, atë diferencë e kanë qitë muajin Shkurt.

Vesel Neziri: Fillimisht i uroj të gjithë besimtarëve muajin e Ramazanit. Është muaj kur i pasur dhe i varfër janë të barabartë. Kisha pas dëshirë që shumë herë ligjet nga Evropa po i marrim dhe po i adoptojmë, andaj kisha pas dëshirë që modelin e Frankfurtit dhe modelin e Londrës, ta ndjekim që në vitin tjetër në muajin e ardhshëm të Ramazanit, që edhe qyteti i Mitrovicës të zbukurohet, për muajin e shenjtë Ramazanit.

Kryesuesja znj. Vesa Broja: Atëherë, për pikat e propozuara u dakordua se kur të na vijmë në kuvend, kështu që po vazhdojmë me miratim të rendit të ditës me ndryshimin që pika e dytë e rendit të ditës të jetë Plani i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024, ndërsa pika e katërt vazhdoi Plani komunal për shërbime sociale në komunën e Mitrovicës.

Kryesuesja në vazhdim vuri në votim këtë rend dite:

1. Miratimi i procesverbaleve nga dy mbledhjet e kaluara
2. Plani i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024
3. Projekt-Plani i veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024-2026
4. Projekt-Plani komunal për shërbime sociale në Komunën e Mitrovicës së Jugut
5. Kërkesa e Sindikatës së të Punësuarve në Komunën e Mitrovicës për mbështetje financiare
6. Raport i punës së Drejtorisë për Shëndetësi për periudhën janar-dhjetor 2023
7. Pyetje dhe përgjigje

Rezultati i votimit 28 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Rendi i ditës u miratua unanimisht.

Pika 1

Kryesuesja hap diskutimin për dy procesverbalet nga mbledhjet e kaluar.

Meqenëse nuk ka të lajmëruar për diskutim atëherë do ti hedh veçmas në votim.

Kryesuesja vuri në votim Procesverbalin e mbledhjes së njëzeteshtatë (27-të) të Kuvendit të Komunës dt. 31.01.2024.

Rezultati i votimit 28 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja e konstatoi të miratuar unanimisht Procesverbalin e mbledhjes së njëzeteshtatë (27-të) të Kuvendit të Komunës dt. 31.01.2024.

Kryesuesja vuri në votim Procesverbalin e mbledhjes së njëzetetë (solemne) të Kuvendit të Komunës dt. 17.02.2024.

Rezultati i votimit 27 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja e konstatoi të miratuar unanimisht Procesverbalin e mbledhjes së njëzetetë (solemne) të Kuvendit të Komunës dt. 17.02.2024.

Pika 2

Kryesuesja hapi diskutimin lidhur me Plani i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024, hap diskutimin.

Xhylljeta Imeri: Tek plani i Kryetarit do të ndalem në disa projekte të shkurtra. Në këtë plan kishte shumë prioritete si rregullimi i disa shkollave, ndërtimi i rrugëve e të tjera, por u befasova si nuk është paraqitur si prioritet vazhdimi i ndërtimit të Çerdhes së fëmijëve në Shipol, ku ndërtimi i saj ka filluar në vitin 2020, si dhe mjetet për staf janë të planifikuara për këtë vit, kurse çerdhet të cilat as nuk kanë filluar fare janë prioritet. Gjithashtu, ndërtimi i aneksit të shkollës “Aziz Sylejmani” paralele e ndarë në Suhodoll ku janë planifikuar 40.000€, nuk është prioritet. Ndoshta emërtimi si aneks i objektit nuk duket i rëndësishëm, por këtu bëhet fjalë për ndërtimin e një klase. Hapësira ekzistuese në të cilën zhvillohet mësimi nuk i plotëson kushtet për mësim. Është një hapësirë e improvizuar në formë trekëndëshi. Mund të themi që edhe kotecet e shpezëve janë më të mëdhenj se kjo klasë. Kështu që kërkoj nga ju kryetar, që këto dy objekte të jenë prioritet i yt për këtë vit që në shtator të funksionalizohet çerdhja për fëmijë në Shipol dhe të ndërtohet kjo klasë për fëmijët të cilët duhet të ketë një ambient më të mirë dhe që i plotëson kushtet për mësim. Po ashtu edhe shuma prej 20.00€ për kabinete, për të gjitha shkollat e qytetit, është një shumë mjaft e vogël dhe kërkoj nga ju që me bartjen e të hyrave vetanake të rritet sadopak kjo shumë.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Me shumë të drejtë, po nuk do të thotë që në plan të punës nuk janë paraqitë që s'kanë me ndodhë, nëse janë pjesë e buxhetit, se në plan të punës mundemi me i paraqitë por nëse s'e kemi buxhetin, është pak më vështirë me u realizua. Kur janë në buxhet, mos me kanë plan të punës, ka mundësi me u realizua. Prandaj, kanë qenë projekte të cilat i kemi diskutua dhe dimë rëndësinë e tyre. E të them të drejtën, kjo Çerdhe e Shipolit është stërzgjatë, e për befasinë time, kur i kemi shpallë procedurat, e kemi shpall me një shumë, por kur i kam pyet inxhinierët, thashë: Pse bre? Më thanë se i kemi harru do pajisje, me i bë pjesë projektit. Ato pajisje e kishim vlerën gati sa krejt projekti. Mirëpo jam i bindur që deri në shtator dhe jam optimist që kjo do të jetë në funksion të përdorimit nga prindërit që janë pjesë e atij lokaliteti. Gjithashtu edhe për aneksin e shkollës në Suhodoll, për shkak se ju keni ngritë, ju keni propozuar dhe e dini gjendjen ma së miri aty, besoj që edhe e njëjta do të realizohet. Dhe krejt në fund, sa i përket kabineteve, zakonisht janë furnizuar prej mallrave dhe shërbimeve dhe kur është furnizim prej mallrave dhe shërbimeve, nuk është specifikisht e lidhur shuma, po ka mundësi që shuma e planifikuar të rritet më tepër dhe të bëhet pagesa. Me qenë projekt kapital, ti duhet me pas shumën për me dhënë për disponueshmëri, ndërsa të mallrat dhe shërbimet mundet me u tejkallua shuma prej 20.00€ dhe me u bë edhe më e lartë, varësisht prej nevojave dhe çka duan me ble.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim Kryesuesja vuri në votim Planin e punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024.

Rezultati i votimit 27 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja e konstatoi të miratuar unanimisht Plani e punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024.

Pika 3

Kryesuesja lidhur me Projekt-Planin e veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos regjistrimit të shkollës 2024-2026, për ta sqaruar fjalën ia kaloi drejtoreshës znj, Drita Kadriu.

Drita Kadriu në pika të shkurta e sqaroi Projekt-Planin e veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos regjistrimit të shkollës 2024-2026.

Kryesuesja e hap diskutimin.

Xhylyeta Imeri: Ju përgëzoj që edhe Komuna jonë po e përmbush obligimin për Plan të Veprimit për Parandalimin e Braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024-2026. Uroj që sa më parë t'i krijoni ekipet në komunë dhe në shkolla për parandalimin e braktisjes së shkollës nga fëmijët dhe të keni suksese. Arsimi duhet të është Strategji Kombëtare në praktikë e jo vetëm në letër, mësimi të bëhet gjithditor, të krijohen kushte më të mira për nxënësit dhe mësimdhënësit, të kenë një kohë të caktuar gjatë mësimi, ku mund të zgjedhin aktivitete sportive, art, lexim. Gjithashtu plan programet të bëhen adekuate për moshën e tyre, jo të jenë të mërziqshme për fëmijët dhe jo të papërceptueshme për ta. Unë mendoj që shkolla duhet të jetë një ambient i ngrohtë që fëmijën e bënë të lumtur. Kemi faktor të ndryshëm që ndikojnë në braktisjen e shkollës nga fëmijët disa nga ta janë: Vijueshmëria jo e rregullt në shkollë; Ngacmimi nga bashkëmoshatarët; Problemet e ndryshme në familje; Problemet sociale e të tjera.

Por këtu mësimdhënësit janë të parët që mund t'i identifikojnë fëmijët që janë në rrezik të braktisjes së shkollës. Mirëpo lidhjet e mira prindër mësimdhënës, bashkëveprimi i tyre rrit mundësinë si në zhvillimin e diturive ashtu edhe në zhvillimin social. Por në parandalimin e braktisjes së shkollës nga fëmijët, dhunës, ngacmimit do të na ndihmonin psikologët në shkolla. Kërkoj nga Kryetari, Drejtorja e arsimit dhe ajo e financave t'i mbledhin forcat dhe të shpallin konkurs për psikolog në shkolla sepse janë shumë të nevojshëm.

Fadil Veseli: Meqenëse Drejtoresha e ceku arsyen dhe peshën që ka ky plan, unë vetëm në pikat shkurtra po i numëroj disa që u përfshin edhe në fjalimin e drejtoreshës, siç është domethënë gjatë hartimit të komisionit që ka hartuar këtë plan, vërehet se ka mungesa të shumta të nxënësve, e sidomos në shkollën e mesme dhe ato kryesisht profesionale. Braktisja e shkollës gjatë tri viteve të fundit, të shihet në total nuk është për t'u shqetësuar shumë, me thënë drejtën. Unë rastësisht një ditë e dëgjova një lajm nga deutsche ëlle që tha Gjermania brenda vitet kanë braktisë shkollën 45.000 nxënës. Mirëpo çka më shtyri më së tepërmi të marr fjalën, është çështja se tash e dy herë mbahet testi PISA në nivel kombëtar, herën e parë menduam që në njëfarë forme nuk është aq serioze dhe nuk i dhamë rëndësi, dhe doli rezultati shumë i dobët. Kurse herën e dytë jo të ketë përmirësim të rezultatit por edhe më i dobët. Edhe ne si kuvendar kemi një lloj përgjegjësie dhe defekti më i madh i kësaj është se askush s'merret me këtë çështje. Krejt është e arsyeshme çështja e mungesës së përjashtimit të nxënësve, mirëpo kjo është veç njëfarë degëze e vogël. Përgjegjësia është prej Presidencës deri te nxënësi, kemi përgjegjësi edhe ne si Kuvendar kemi përgjegjësinë tonë, pse jemi kaq të dobët. Dhe nuk është ajo organizatë e thjeshtë, që të themi hajde veç e kanë bërë vlerësimin, por një organizatë ndërkombëtare që ka peshë dhe është serioze. Kemi dal aq dobët dhe mos të merret askush me atë, është pak një pikëpyetje shumë e madhe.

Hysen Muzliukaj: Pajtohem me z. Veseli po ne duhet me u merr se çka nuk është duke funksionu arsimi mirë në nivel lokal. Edhe testi PISA nuk është që po mbahet vetëm vitin e kaluar, por është qe dy vitet e fundit por edhe më përpara. Sa i përket këtij plani, unë i kam dhënë vërejtjet e mia edhe në KPF, se p.sh. kur i pash shifrat që 3.500€broshura. Unë po propozoj nëse ka mundësi, që në këtë plan nuk është ideja veçse mos me u shpenzu mjetet, por kështu mjete me shku tek nxënësit që këto broshura me i punuar nxënësit vet. Me bër një lloj konkursi brenda shkollës, njëfarë gare shkollore, që këto broshurat të punohen në qoftë edhe në letër të bardhë me vizatimet tyre, me shkrimet tyre, po me punu për sensibilizim. Le të jenë njëfarë stimulimi për nxënësit dhe bëhet njëfarë praktike në të gjitha shkollat. Pastaj, 8.500 ke vizita për nxënësit e klasave të gjashtë dhe shtata, nuk është se jam kundër vizitave, se e vërteta është se sa më shumë se dalin dhe shohin

e bëjnë. Ideja ime ka qenë tek infrastruktura në arsim, atë ditë kur u kanë tema në KPF. Drejtoreshë, a kemi mundësi në këtë plan me inkuadru, se tash pothuajse infrastrukturë më shumë se tash që kemi, s'kemi pas asnjëherë, këto palestra që i kemi, përveç orarit mësimor, a kemi mundësi me gjet një metodë që me i lejua të shtunave dhe të dielave për komunitetin dhe nxënësit e komunitetit që jetojnë aty. Me bë gara, ushtrime, çfarëdolloj sporti, qoftë mënyrën qysh e gjeni, jam në gjendjen ashtu edhe me ju ndihmua në këtë aspekt. Një plan, një orar, kërkesat e prindërve e nxënësve, në mënyrë që nga ora nëntë apo dhjetë, të shtunave dhe të dielave, se edhe ashtu mirëmbajtësit teknik kanë me mbajt orarin të punës. Kjo infrastrukturë, realisht po na vdes, në momentin që nuk shfrytëzohet ajo bëhet më e dëmtuar se sa kur shfrytëzohet. Pra këto palestra, do të thotë ato çka i kemi si p. sh shkollën e muzikës dhe të gjitha objektet, që nxënësit mos ta kenë veç orarin mësimor obligativ që me qenë në ato. Kjo kish me bo vullnetin e motivin dhe me gjet edhe metodën që as mirëmbajtësit teknik, mos me i lënë me u merr me atë pjesë atë ditë, që nxënësit kur të jenë aty apo prindërit kur të vijnë me fëmijët me e kthye në gjendjen e mëparshme siç ka qenë objekti në ato pjesë ku ata e kanë shfrytëzuar.

Flutura Beka Kamberaj: Në këtë plan janë paraparë disa objektiva për parandalim të braktisjes së shkollës, mirëpo përveç tek objektivi 1.1 dhe 1.2 ku treguesit janë kuantitativ dhe janë të kostuara, dihet sa nxënës, sa bursa, objektivat e tjera specifike treguesit nuk janë kuantitativ, nuk janë të caktuara p.sh. Numri i panairëve, numri i shkollave, numri i nxënësve pjesëmarrës etj, Në bazë të këtij plani nuk e dimë çfarë rezultate do të arrihen në periudhën 2024-2026 sipas planit. Objektivat janë të kostuara dhe përgjegjës kryesor është komuna, ka institucione mbështetëse por nuk dihet ato a kanë obligime financiare në realizim të këtij plani, andaj kjo shumë prej 81,620€, a është në harmoni me buxhetin e komunës. Plani i veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos regjistrimit në shkollë, tregon statistika të braktisjes së shkollave, dhe objektivat për parandalim të braktisjes mirëpo në plan nuk pash ndonjë statistikë të fëmijëve të mos regjistruar në shkollë, a keni ndonjë të dhënë sa i përket kësaj pjesë të planit dhe objektiva konkrete për ta.

Nafije Rexha: Sa i përket çështjes së projektit të planit të veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos regjistrimit të shkollës d.m.th vlen të përgëzohet plani i veprimit nga Drejtoresha e Arsimit e cila e potencoj në pika të shkurtra, aktivitetet për format e punës, të cilat do të organizohen përmes objektivave dhe strategjive të punës. Dhe përderisa i takoj kësaj pjesë të mësimdhënies, jam pjesë e kësaj kategorie vlen të theksohet se pikërisht edhe kjo është ndikim negativ në standardin dhe në testimin me testim PISA, siç e potencoi më herët edhe kolegu z. Veseli, sepse kur në shkollat tona ka mungesa të shumta të nxënësve dhe kur prindërit nuk janë shumë të interesuar që të punojnë me fëmijët e tyre, në mënyrë që të parandalojnë braktisjen e shkollave, automatikisht kjo reflekton edhe në cilësinë e mësimdhënies. Sepse pikërisht në mësimdhënësit jemi ata të parët të cilët ballafaqohemi me plan-programin të cilin e bëjnë për vite të caktuara, sepse pikërisht me ata nxënës që mungojnë, atëherë ne jemi të obliguar që të mbajmë edhe mësim e plotësuese e që nuk është aspak e lehtë. E me vet faktin që tha sa po punohet në motivimin dhe me ngritjen e cilësisë e testit Pisa, pikërisht këtu duhet të referohemi nivelit qendror. Sa është duke bërë niveli qendror për mësimdhënësit në mënyrë që puna e tyre të kompensohet dhe të ketë një mësimdhënie më efektive. Pra, mësimdhënësit duhet të kompensohen me punën e tyre, pra sa ju ka vlerësua puna atyre që pas lufta, derisa shumë sot janë në pension dhe nuk u është kompensuar puna që e kanë bërë. Deri sa mësimdhënësit me çfarë nuk po ballafaqohen në ditët e sotme kur e dimë se fëmijët kanë filluar të merren edhe me mjete të ndryshme narkomane. Pra ne sot si shoqëri duhet së pari ta vetëdijësojmë këtë shoqëri që t'i vetëdijësojmë në rend të parë prindërit për edukimin e fëmijëve të tyre, pastaj të flasim me gojë të hapur dhe të marrim masa që mësimdhënësit nuk janë të nivelit. Unë në bazë të përvojës sime 35 vjeçare e kam theksuar shpesh, se mësimdhënësit janë të stërlodhur nga mosrespektimi, nga mos përmbushja e kushteve esenciale për ata, për të cilat ata kanë nevojë. Nuk po flasim për nivelin komunal, por për nivelin qendror që duhet t'i thërrasin mendjes dhe të ndahet buxhet i caktuara për sferën e arsimit nëse duam të kemi

një PISA të suksesshme. Çfarë po kontribuojmë? Një kërkesë për shkollën “Abdullah Shabani” e kemi bërë përmes deputetes znj. Ganimete Musliu, kërkesë të cilën e kam ngrit unë përmes paneleve të OSBE-së. Publikisht i them Armend Mujës dhe Arjeta Fejzës që duhet të jenë në nivelin e përgjegjësisë dhe ish dashtë që në prag të miratimit të buxhetit të përkrahet kërkesa për ndërtimin e ndërtesës së shkollës “Abdullah Shabani”, prej të cilës ka dalë kryeministri i parë i vendit Bajram Rexhepi. Kështu që për hir të kësaj dhe që kjo shkollë njihet në nivel të Kosovës është e përfshirë në kurrikulat e Kosovës. Për punën të cilën është bërë me vite të tëra, mësuesit të shtunave dhe të dielave kanë bërë trajnime çka do që ka ofruar niveli qendror apo niveli lokal, mësime të ndërtimit ju kanë përgjigj çdo ftese. Kështu që, drejtoreshë, faleminderit shumë për këtë iniciativë të këtij plani të veprimit, ku edhe unë si pjesë e tij do ta jap kontributin tim, siç e kam dhënë në vitet e para, në gjenerata me nxënësit e mi që fatkeqësisht ndoshta e nuk mund të them se krejt mësime të ndërtimit janë të përkryer por me ta le të merret inspektorati, janë rregullat, janë normat, kush nuk punon duhet të ndëshkohet. Nëse funksionalizohen këto, atëherë edhe cilësia në arsim ka me qenë ndryshe. Çdo herë e shoh që, sa herë e marr fjalën, për diskutimin për arsim, unë arsimin e kam pikë të dobët edhe ju kam afrua gati ndoshta edhe pensionit, por nuk jam aspak e kënaqur. Kështu që shpresoj dhe besoj që në një të ardhme do të do të do të trajtohem më të dinjitetshëm sepse në të vërtetë baza dhe shtylla e shtetit është pikërisht arsimi edhe prindër duhet t’i thërrasin mendjes dhe përgjegjësisë që ta kryejnë punën si duhet me fëmijët e tyre e mos t’i kërkojnë të gjitha nga mësime të ndërtimit, sepse edukata merret në bazë.

Elidiana Budini Haziri: Unë po mendoj që pos që është obligim ligjor, plan i veprimit duhet të jetë edhe një obligim moral. Ne po e dimë që nataliteti vetëm ka rënë, statistikisht nataliteti ka rënë. Nga ana tjetër, po e dimë që me liberalizimin e vizave është edhe që familjet po shkojnë jashtë Kosovës, për çdo ditë numri i nxënësve është duke rënë. Qëllimi i këtij plani, me sa unë e kuptoj, duhet që të paktën ata nxënës që janë brenda komunës mos të jenë në rrugë por në shkollë. Ky plan thjesht na ofron mekanizma që të arrijmë nxënësin ta ofrojmë më pranë shkollës e mos ta lëmë të endet nëpër rrugë, për atë mendoj që është i nevojshëm dhe duhet të jetë obligim për secilin për ne ta votojmë.

Kushtrim Zeneli: Sa për sqarim për znj. Rexha se e ka cekë edhe herën e kaluar këtë çështjen e shkollës “Abdullah Shabani” dhe sigurisht se ne e kemi diskutuar edhe me deputetët tanë që i kemi pra Armend Mujën dhe Arjeta Fejzën, ata na kanë thënë që ne ju kemi drejtuar zyrtarisht me një email MASHT-it, ku kanë kërkuar që me u përfshi edhe ata kanë thënë që s’ka pas as kërkesë nga komuna edhe për këtë është e njoftuar edhe drejtoresha Drita Kadriu që i kanë thënë që me bërë zyrtarisht një kërkesë për shkollën “Abdullah Shabani”. Mundet drejtoresha me na e sqaruar. Ndërsa sa i përket në raportit, është përmend për nxënësit që udhëtojnë me mbi një kilometër, kjo ka fillua dhe me u bërë tepërt, unë e kuptoj që ndoshta mundemi me pas probleme me tenderë ose diçka, veçse me marrë kaq shumë kohë thuajse po bëhet një muaj që nxënësit nuk kanë pas transport, ecin në këmbë rreth 5 km edhe në shumicën e rasteve po kanë edhe humbje të orëve, pra kjo ndikon edhe në braktisjen e shkollave. Pra kërkoj që të merret me urgjent transporti i nxënësve. Dhe ajo çka më intereson është se a ka dështuar projekti E-shkollori .

Vesel Neziri: Faktikisht raportet nuk na mungojnë, ligjet nuk na mungojnë, po kushtet dhe dëshira për mësim po mungon. Jam shumë i bindur që nxënësit tonë po t’i kishit pyet dhe të kishin pasur testin PISA se cilët janë VIP-at e degjenerimit, serialet televizive, futbollistët më të mirë, me siguri se me testin PISA do të ishim të parët. Çka dua me thanë me këtë? Na po merrem veç me mjekim dhe jo me parandalim. Mjekimi është i kushtueshëm. Meqenëse se mësime të ndërtimit me e ngritë shqetësimin e vet, por ofertën hej. Çka ishte oferta e hej? Oferta Hej është që të gjithë nxënësit t’i largon prej shkollave, që tërë natën mund të bisedojnë pa pare dhe asnjëherë kush nuk e ngriti shqetësimin pse fëmijët e tyre ju ofruat një telefon, një numër falas dhe mundësi e bisedave tërë natën me fol pa pare. Në raport sigurisht që janë të evidentuara saktë krejt fëmijët që mungojnë, janë fëmijë me probleme familjare ose janë fëmijë të cilët kanë divorc mes veti

prindërit. Pra, shkatërrimi i familjes po vazhdon edhe më tutje, mungesa e një niveli global kombëtar për me ngritë vetëdijen mungon në librat tona, dashuria për shkollë mungon në familjet tona, sot kjo dashuri po mungon, kjo politikë po mungon dhe aq ma keq kur sot po kërkohet me të madhe që të lindin edhe fëmijët pa prind, që është absurdi më i madh dhe kjo shoqëri me këtë rrugë dhe me këtë rrugëtim po shkon drejt degjenerimit dhe shkatërrimit. Nuk janë të largëta rastet e serialeve ku bëjnë klonimin e njeriut, i fëmijëve dhe jo rastësisht kanë ndodhur ato, por kanë qenë si model që na të klonojmë fëmijë dhe të mos i dihet prindi. Në qoftë se vazhdohet kështu, kjo që po ndodh sot, është shumë pak çka do të ndodhë nesër, në qoftë se ne nuk përkujdesemi për rregullimin e çështjes në familjet tona.

Drita Kadriu: Ajo që është diskutu prej jush, normalisht janë eksperiencia, përvoja, nevoja që ju i shfaqni dhe janë shumë të mirëpritura për secilin. Mitrovica nuk ka kapacitete të infrastrukturës me organizua mësimin gjithë-ditor siç e përmendi deputetja, për shkak të ndërrimeve dhe numrit të madh të nxënësve në shkollat e qytetit. Ndërsa në shkollat e rretheve jemi duke e planifiku riorganizimin sipas Udhëzimit Administrativ që e ka aprovu Qeveria dhe besoj që ndoshta në katër vitet e ardhshme pas këtij mandati, ka me pas mundësi dikush me i vë një theks më të madh te këto çështje, sepse na lidhen edhe vendet e punës mësimdhënësve mandej në riorganizim. Besoj që mësimdhënësit e kanë marrë mesazhin gjatë hartimit të këtij plani që ta përfshijnë si tema ndërkurrikulare edhe çështjen e braktisjes dhe janë duke e zhvillu herë pas here në lëndët e tyre. Më shumë efekt në këtë plan kanë nxënësit të cilët janë problematikë dhe që vijnë prej familjeve problematike. Ne kemi pas një takim Drejtoreshën Regjionale e Policisë, na ka thirr dhe kemi fillua aty me i adresua disa të dhëna të nxënësve që vijnë me një begrand të tillë, në mënyrë që t'i kemi të she njëzuar dhe të dimë afërsisht se gjatë procesit të shkollimit, po edhe pas çfarë po ndodh, jemi në procedura të hartimit të një forme tabelore jo shumë të koklavitur, po shumë lehtë të shfrytëzueshëm. Gjithashtu, ju njoftoj që ne kemi nda gjashtë pozita për psikologë dhe po besojmë që këto gjatë këtij viti kemi me i rekrutu për herë të parë Mitrovica tanimë e ka një psikolog në shkollën “Çajupi”. Kështu që jemi të lumtur që gradualisht kena fillu me adresu edhe këtë problem. Mungesat e nxënësve, kur i kemi analizu zoti Fadil, dalin më shumë mungesat e nxënësve të cilët lidhin marrëdhënie pune, fillojnë me punu, posaçërisht nxënësit e shkollës ekonomike, nxënësit e shkollës teknike. Dhe po mundohemi me gjet një mes të artë bashkë me shkollat, në mënyrë që nxënësit edhe ta vijojnë mësimin në oraret e tyre të rregullta, jo veç qysh e parasheh ligji për praktikat profesionale, por nxënësit, që vërtet kanë marrëdhënie pune ata atyre me ju krijua lehtësime me e viju shkollimin edhe janë duke e bërë shkollat ekonomike dhe ajo teknike. Nuk duan ndoshta shumë me u zgjat te testi PISA përgjegjësia e saj është prej lart deri te familja, po edhe prej familjes deri në krye. Sepse testi PISA nuk është diçka tjetër, përveç një qasje e re në metodologji të mësimdhënies dhe për me ndërrua qasjen e tridhjetë mijë mësimdhënësve duhen aftësime profesionale që duhet me i pas mësimdhënësit. Ne këtë vit e fillojmë trajnimin e vazhdojmë trajnimin e mësimdhënësve, por buxheti për trajnimin e mësimdhënësve kryesisht është i centralizuar në nivel ministrisë dhe nuk ka pas programe të akredituara deri para dy jave. Kështu që tash janë akreditu programet e trajnimit dhe ne do të vazhdojmë me procedurat e trajnimit. Nuk pres që testi PISA, edhe pas vlerësimit të ardhshëm ka me u avancu shumë, për shkak se duhet goxha disa vite me investua në këto ndryshimet në qasje të mësimdhënies e mandej me fillu me i pa rezultatet e para. Nëse dikush tenton ose mendon që me këtë temë ose mbërrin diçka qoftë politikisht, besoj që hiç nuk është temë e këndshme për asnjë palë në sistem, por është dashtë me investu goxha shumë në aftësim, se mësimdhënësit janë të përgatitur, kërkojnë informacione të reja. Plus mos harroni, mësimdhënësit e kanë mundësinë edhe me u vetë-arsimua. Na e dimë, gjyshërit tanë janë vetëarsimu, janë mësu me lexua. Tash mësimdhënësit kanë mundësi me u vetëtrajnu përmes platformave të ndryshme elektronike që janë online edhe këtë motiv ne i ndajmë çdo ditë me ta, po besoj që një klimë e bashkëpunimit edhe një dashuri me ju përgjigj aktiviteteve e kemi gjetur shumë të madhe tek mësimdhënësit. Deputet Hysen Muzliukaj, për atë që broshurat

kanë me u hartua prej nxënësve, ideja është jashtëzakonisht e madhe e mirë ka mundësi që ne me dediku në temë që broshurat në formë ose të vizatimeve e tjerë të bëhen nga nxënësit, po do të jemi dëshmitarë bashkërisht cilido prej juve si asambleistë dëshiron me marrë pjesë aty. Tek palestra sportive goxha është investuar në to. I kemi blerë edhe do pajisje që ju ndihmojnë teknikëve me i pastru janë shumë të rëndësishme, sepse po mbahet higjiena mirë. Momentalisht po shfrytëzojmë për shkak të Omni Sportit nga shumë klube sportive. Edhe ideja e shfrytëzimit të komunitetit është ide shumë e rëndësishme që besoj nëse veç zërthehet edhe problemi i Omni Sportit edhe shkollat lirohen që komuniteti me pas atë qasje. Kështu që jam mirënjohëse për propozimet edhe shumë falënderuese. Ky plan i veprimit sigurisht do të shoqërohet me aktivitete, të cilat lidhen drejtpërdrejt me shpenzimin. Deputetja Flutra, lidhen drejtpërdrejt me shpenzimet dhe ne jemi këtu mandej me i analizu e me i pa ku çka kemi shpenzua dhe sa. Deputeti Kushtrim, është problem transporti i nxënësve në lotin ku ka përfunduar kontrata, kemi bërë përpjekje me adresu shumë shpejt e kemi adresu dhe do të bëjmë zgjedhje gjatë këtyre ditëve. Ne e kemi adresu e kemi bërë një zgjedhje afatshkurtër derisa ta bëjmë tenderin për transportin e përgjithshëm, që me një shtator na duhet me pas tenderin të vendosur në të gjitha pikat. Atë që po du me shtu, është pika të grumbulluese të nxënësve, sepse në terren ka dalë një pakënaqësi sa i përket mbledhjes së nxënësve, bashkë me komunitetin edhe me drejtorë shkollash do t'i përcaktojnë pikat ku transporti shkon, po normalisht se as transporti nuk mundet me shku te secila shtëpi se terreni shumë i hapur. Edhe një çështje tjetër, sigurisht kanë me na dalë informatat edhe ma të detajume, sepse po e analizojmë transportin, duhet me qenë ndoshta me kilometra, jo me ditë sepse raportimi në kilometra dhe ditë do të dallon, do të jetë shumë më i përafërt edhe më i saktë me kilometra. E-shkollori nuk ka dështu, ne kemi platformën të cilën janë duke e përdorë shkollat, vazhdimi i pilotimit të kësaj është në procedura të prokurimit edhe ne po presim që ata me i përfunduar detyrat që duhet me i kry edhe me i shfrytëzuar. E di që kom informata, kryeministri ka bisedu me të gjitha palët që ofrojnë këto shërbime dhe janë tendenca me bë një kornizë të përgjithshme për sistemin e menaxhimit të dhënave në arsimin para universitar. Ministria e Arsimit e ka një s-mija, por janë të dhëna veç teknike, po nuk e ka idenë e e kësaj çfarë po diskutohet në Qeveri edhe nëpër drejtoritë komunale. Unë po e shfrytëzoj rastin të gjithëve, veç e veç me ju falënderua për kontributin që po e jepni në dokumentet e arsimit, për frymën, pozitivitetin që po e jepni gjithandej nëpër mësimdhënës dhe besoj që bashkërisht kemi me dal më mirë. Edhe një informatë krejt në fund, presim me marrë raportin e projektit të shëndetësisë. Do t'ua sjellim edhe juve ndoshta në pikat kryesore, ku shëndeti i fëmijëve tonë është më i dëmtuar, që bashkërisht të gjejmë ndonjë zgjidhje dhe të ecim tutje. Faleminderit shumë secilit.

Xhyljeta Imeri: Vetëm desha me jua rikujtu, ndoshta e keni parë kur komentet e mia, këtij plani. që të bazohen në listat e vaksinimit, janë shumë të rëndësishme t'i verifikoni fëmijët të cilët nuk kanë arrit me u regjistrua në klasën e parë. Bazë në listat e vaksinimit është për secilën lagje, i kanë numrat e telefonit, gjenden adresat e tyre edhe janë pika shumë të mira referuese për me i evidentu fëmijët të cilët nuk janë regjistruar.

Drita Kadriu: Veç me ua sjell në kujtesë se problemi kryesor të mosregjistrimi në klasat e para është lagjja këtu buzë Ibrit te komuniteti rom, ashkalinj dhe egjiptian, ndërsa te shumica e popullsisë është rritë përfshirja, duke krijuar këto klasat e bashkëngjitura për fëmijë edukimin e fëmijërisë së hershme. Kemi bërë edhe një marrëveshje me Caritas-in që shpejt do t'i meremetojmë edhe pesë klasë të reja, edhe këto tri çerdhe që janë në plan sivjet, po besoj që e rritin përfshirjen e fëmijëve edhe e ngrisin kështu përgatitjen e tyre për regjistrimin në klasën e parë.

Flutura Beka Kamberaj: Drejtoreshë, meqenëse nuk kemi ndonjë statistikë të mos regjistrimit të shkollave të përfshira në plan, ndërsa titulli domethënë i komplet të planit është plani i veprimit për parandalim të shkollës dhe mos regjistrimi të shkollës. Ai është dashtë me u hejë kjo pjesë, se s'kemi as objektiva apo as statistika të fëmijëve, të cilët nuk janë të regjistruar nëpër shkolla. Në

fakt, komplet plani po thirret vetëm në veprime të parandalimit të braktisjes së shkollës. Në qoftë se nuk kemi të dhëna të sakta, bile së paku mos të jetë titulli i planit edhe pjesa tjetër.

Drita Kadriu: Plani nuk ka të bëjë me hyrjen e fëmijëve në shkollat në arsim. Momentalisht unë nuk i kam këto të dhëna, po qëllimi i planit është me parandalua braktisjen, nuk është i hyrjes së fëmijëve në klasë të para, por mundemi me i gjetë ato të dhëna, nuk është ndonjë problem. Mos regjistrimi është kryesisht për klasat e mesme. Është problemi i rritjes, përfshirjes në edukimin e hershëm, që përmend Gjyli. Ndërsa problemi është tej kalueshmëria prej klasës nëntë në të dhjetën, aty ka gjasa gjithmonë me u braktisë shkollën, po edhe gjatë shkollimit të mesëm që braktiset për shkaqe ekonomike e sociale. Po nganjëherë edhe klasa edhe shkolla nuk krijon klimë, mos me braktisë nuk duhet me u shty me ata të dobët, ata duhet me u integrua sa më shumë, ju duhen përgjegjësi.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim Kryesuesja vuri në votim Planit të veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos regjistrimit të shkollës 2024-2026.

Rezultati i votimit 27 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja e konstatoi të miratuar unanimisht Planit e veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos regjistrimit të shkollës 2024-2026.

Kryesuesja në mungesë të kuorumit mbledhjen e shpalli të mbyllur.

Mbledhja përfundoi punimet në ora 11:45 min.

Mitrovicë

Procesmbajtës:

Kryesuesja e Kuvendit

Afërdita MAXHUNI

Vesa BROJA




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica Sou...

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. _____ dt. _____
Mitrovicë



NJOFTIM

Në mbështetje të nenit 68, paragrafi 68.3 i Ligjit Nr.03L-40 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës; nenin 61 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-048 Për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë; në nenin 25 dhe 26 të Statutit të Komunës; nenit 6 pika 1.2, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 Për standardet minimale të konsultimit publike në Komuna; bazuar në Rregulloren Komunale për Transparencë, Drejtoria për buxhet dhe financa në bashkëpunim me Drejtoritë tjera dhe Zyrën për informim ORGANIZON:

KONSULTIM PUBLIK

PËR

PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORËS NR.02/2019 PËR TAKSAT, TARI FAT DHE GJOBAT KOMUNALE

Njoftohen të gjithë qytetarët, grupet e interesit dhe palët tjera të interesuara që të marrin pjesë në Konsultimin Publik për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr.02/2019 për Taksat, Tarifat dhe Gjobat Komunale.

Konsultimi publik do të mbahet të enjten më dt. **21.03.2024** në sallën e mediave në Komunë duke filluar nga ora 14.⁰⁰.

Njëkohësisht të gjithë qytetarët dhe të interesuarit tjerë në afatin prej 8 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi të gjitha propozimet, komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe pikëpamjet mund t'i bëjnë përmes ueb faqes së Komunës <https://kk.rks-gov.net/mitrovicëejugut/> ose drejtpërdrejtë në Zyrën pritëse dhe Zyrën Nr. 60 të Sekretarisë së Kuvendit të Komunës, ku edhe mund të merret Draft Rregullorja Për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr.02/2019 Për Taksat, Tarifat dhe Gjobat Komunale.

Draft Rregulloren Për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr.02/2019 Për Taksat, Tarifat dhe Gjobat Komunale mund ta gjeni të publikuar në ueb faqën e Komunës së Mitrovicës së Jugut duke klikuar linkun: <https://kk.rks-gov.net/mitrovicëejugut/category/shpalljet/njoftimet/>

Mitrovicë

Kryetarja e Komisionit

Tyrkan Dedinja
Tyrkan Dedinja





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	25/03/2024
REFERENC-Ë:	02-434/01-0021333/24
PËR/ZA/TO:	Komitetin për Politikë e Financa Kuvendin e Komunës
CC:	Arkivit
NGA/OD/FROM:	z. Bedri HAMZA, Kryetar i Komunës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozim për Miratim të Rregullores Per Ndryshimin dhe Plotesimin e Rregullores 02/2019 Per Taksa, Tarifa dhe Gjoha Komunale



Bazuar në nenin 58 pika (h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, dhe nenin 13 të Statutit të Komunës së Mitrovicës së Jugut Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Kryetari i Komunës i propozon, Komitetit për Politik dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës këtë:

PROPOZIM
(Për Miratimin e Rregullores Per Ndryshimin dhe Plotesimin e Rregullores
02/2019 Per Taksa, Tarifa dhe Gjoha Komunale)

I propozohet Komitetit për Politik dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës që të miratojë Rregullorën për Ndryshimin dhe plotësimin e Rregullorës 02/2019 Për Taksa, Tarifa dhe Gjoha Komunale

ARSY ETIM

Kryetari i Komunës me Vendimin Nr. 01-020/04-0009038/24, dt. 06/02/2024 ka formuar Komisionin për hartimin e Draft-Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullorës 02/2019 Për Taksa, Tarifa dhe Gjoha Komunale, ku ky komision ka përfunduar Draftin Final të Rregullorës së lartcekur, konform Vendimit për emërimin e komisionit dhe Rregullores Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës. Pas përfundimit të të gjitha procedurave të parapara ligjore për hartimin e këtij drafti, dhe duhe u bazuar në nenin 58 pika (h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, dhe nenet 13 dhe 84 të Statutit të Komunës së Mitrovicës së Jugut Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, i propozojmë Kuvendit të Komunës përmes Komitetit për Politik dhe Financa që të miratojë këtë Rregullore.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	25/03/2024
REFERENCË:	
PËR/ZA/TO:	znj. Vesa BROJA - Kryesuese e Kuvendit të Komunës z. Bedri HAMZA – Kryetar i Komunës
CC:	Anëtarët e Kuvendit të Komunës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Nazmi JASHARI – Udhëheqës i Sekretarisë së Kuvendit
NGA/OD/FROM:	z. Tyrkan Dedinja, Kryetare e Grupit Punues për Hartimin e Projektit-Plotesim Ndryshimi i Rregullres 002/2019 Per Taksa,Tarifa dhe Gjoha Komunale
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport nga Konsultimi Publik për Draft –Projektin Per Ndryshimin dhe Plotesimin e Rregullores 02/2019 Per Taksa,Tarifa dhe Gjoha Komunale – 2024

Hyrje

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Mitrovicës së Jugut Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, nenin 14, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, të Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 Për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, nenin 6 dhe nenin 7, paragrafi 1.3, nenin 13 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2018 Për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, dhe me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politikëbërjes dhe vendimmarrjes në Kuvendin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, Grupi Punues ka shpall Diskutimin Publik për Draft- Projektin Per Ndryshimin dhe Plotesimin e Rregullores 02/2019 Per Taksa,Tarifa dhe Gjoha Komunale – 2024, për datën 21/03/2024, në Sallën e medjave ne Komunë, duke filluar nga ora 14:00 h.

Ecuria e procesit

Grupi Punues në harmoni me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2018 Për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, ka publikuar Njoftimin për Konsultim Publik të Draft Projektin Per Ndryshimin dhe Plotesimin e Rregullores 02/2019 Per Taksa,Tarifa dhe Gjoha Komunale – 2024, në ueb faqen e Komunës 8 (tetë) ditë para mbajtjes së takimit në linkun: <https://kk.rks.gov.net/mitrovicesejugut/wp-content/uploads/sites/18/2023/03/RREGULLORJA-NR.PER-PLOTESIMIN-DHE-NDRYSHIMIN-E-RREGULLLORES-NR.02-2019.doc>, dhe në rrjetet

sociale të Komunës, dhe po ashtu Njoftimi është vendosur edhe në hyrje të objektit të Komunës.

Njoftimi për Konsultim Publik është shpall në afatin e paraparë ligjor, respektivisht, nenin 16 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2018 Për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, duke u interesuar që të sigurohet Njoftim i Plotë dhe i duhur për palët e interesuara. Me Njoftimin për Konsultim Publik palët e interesuar janë njoftuar me datën, vendin dhe kohën e mbajtjes së takimit publik. Njoftimit i është bashkangjitur Drafti i Planit komunal për Menaxhimin e Mbeturinave, që ka qenë objekt i konsultimit publik, shpjegime shtesë, si dhe informatat për personin përgjegjës për pranimin e komenteve.

Metodat e Konsultimit	Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/kontribuuesve
1. Konsultimet me shkrim/në mënyrë elektronike	12 ditë	-
2. Publikimi në ueb faqe	8 ditë para mbajtjes së takimit kryesor	-

Në konsultim publik për Draft Projektin Ndryshimin dhe Plotesimin e Rregullores 02/2019 Per Taksa,Tarifa dhe Gjoha Komunale – 2024 kanë marrë pjesë: Grupi Punues i Draft – Planit, Njësia për Komunikim me Publikun, disa nga Drejtorët Komunal.

Nuk ka pasur pjesëmarrës tjerë.

Vlen të theksohet se Grupi Punues nuk ka pranuar sugjerime përmes e-Mail-it, gjatë periudhës së Diskutimit Publik brenda afatit kohor të përcaktuar me Udhëzimin Administrativ Nr. 06/2018.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Grupi Punues _____

Dt. 21/03/2024

Mitrovicë

DISKUTIM PUBLIK

PËR _____

Lista e pjesëmarrjes:

Nr.	Emri e Mbiemri	Data	Nënshkrimi
1.	Isabelle Ismaili	21/03/2024	Isabelle Ismaili
2.	Tajvan Dedeeva	21/03/2024	Tajvan Dedeeva
3.	Florent Abrashi	21/03/2024	Florent Abrashi
4.	Dajina Mehmeti	21/03/2024	Dajina Mehmeti
5.	Mentor Urkani	21/03/2024	Mentor Urkani
6.	MIRANDA VORFAJ	21/03/2024	Miranda Vorfaaj
7.	GONXHE PROKAZI	21/03/2024	Gonxhe Prokazi
8.	Donjeta Maxhuni	21/03/2024	Donjeta Maxhuni
9.	Besë Hasani	21/03/2024	Besë Hasani
10.	ARDIAN BRAHIMI	21/03/2024	Arrian Brahimi
11.	NGJHAL DEDA	21/03/2024	Ngjhal Deda
12.	FLORENT ABRASHI	21/03/2024	Florent Abrashi
13.	SHYHRETE PEÇI	21/03/2024	Shyhrete Peçi
14.	Borot Jashari	21/03/2024	Borot Jashari
15.	Adam Jashari	21/03/2024	Adam Jashari
16.	Sadije Jashari	21/03/2024	Sadije Jashari
17.	DRITA IBRAHIMI	21/03/2024	Drita Ibrahim
18.	Ardita Veseli Gjinovci	21/03/2024	Ardita Veseli Gjinovci
19.	VALON BRAHIMI	21/03/2024	Valon Brahimi
20.	Vlora Haxhiu	21/03/2024	Vlora Haxhiu
21.		21/03/2024	
22.		21/03/2024	
23.		21/03/2024	
24.		21/03/2024	
25.		21/03/2024	

Tyrkan Dedinja

From: Tyrkan Dedinja
Sent: Friday, February 23, 2024 10:09 AM
To: Eldar Apuk
Cc: 'igballe.islami@rks-gov.net'; Zenel Citaku
Subject: Lektyrimi i Rregullores 2023
Attachments: Rregullorja Nr. --- Për Plotësim-Ndryshim të Rregullores Nr.02-2023 LEKTYRIM.doc

I/e nderuar ,

Ne attach gjeni të bashkangjitur Regullorën për Ndryshim Plotësim Për Taksa ,Tarifa dhe Gjoba Komunale 2023, për të cilën kërkohet lektyrimi nga Kuvendi Komunal.

Paraprakist Ju faleminderit!

Me respekt!

Tyrkan Dedinja
Zyrtare për Buxhet dhe Financa
Drejtoria për Buxhet dhe Financa
Komuna e Mitrovicëa
Mobil: +386 (0) 43-890-115
E-mail:tyrkan.dedinja@rks-gov.net

Tyrkan Dedinja

From: Eldar Apuk
Sent: Friday, February 23, 2024 10:57 AM
To: Tyrkan Dedinja
Subject: Korigjim
Attachments: Rregullorja Nr. --- Për Plotësim-Ndryshim të Rregullores Nr.02-2023 LEKTYRIM.DOC

Tyrkan Dedinja

From: Lulzim Hajra
Sent: Tuesday, March 5, 2024 9:47 AM
To: Tyrkan Dedinja
Cc: Bukuriye Ujkani; Teuta Selmani
Subject: RE: DRAFT RREGULLORJA PER TAKSA TARIFA DHE GJOBA KOMUNALE

Përshëndetje e nderuar, së pari ju përgëzoj për punën tuaj sa i përket hartimit të kësaj Draft – Rregulloreje, ne kemi dhënë komentet tona edhe në E-Mail-in paraprak dhe sa i përket pjesëve të shtuara nga Drejtoritë përkatëse në këtë Draft e njëjta është në rregull në aspektin formal-juridik.

From: Tyrkan Dedinja <Tyrkan.Dedinja@rks-gov.net>
Sent: Monday, March 4, 2024 2:06 PM
To: Adem Fazliu <Adem.Fazliu@rks-gov.net>; Lulzim Hajra <Lulzim.Hajra@rks-gov.net>; Bekim Sadiku <Bekim.Sadiku@rks-gov.net>; Fitim Rama <fitim.rama@rks-gov.net>
Cc: Igballe Islami <Igballe.Islami@rks-gov.net>; Florent Abrashi <florent.abrashi@rks-gov.net>; Dafina Mehmeti <Dafina.Mehmeti@rks-gov.net>
Subject: DRAFT RREGULLORJA PER TAKSA TARIFA DHE GJOBA KOMUNALE

Të nderuar,

Shpresoj të jeni mirë dhe punët po ju ecin mbarë.

Së pari në emër të grupit punues Ju falenderoj për vlerësimin dhe përgjigjet e juaja lidhur me Draft Rregullorën Për Taksa, Tarifa dhe Gjoba Komunale.

Duke u bazuar në Rregullorën (MAPL) Nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës, Ju lutem nëse ka mundësi sipas Përgjegjësive të juaja të bëni vlerësimin dhe harmonizimin me legjislacionin në fuqi vetëm për pikat e shtuara me vonesë nga drejtoritë në vijim:

1. Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik
2. Drejtoria për Mirëqenje Sociale
3. Drejtoria e Inspeksionit

Te bashkangjitur gjeni Drafte Rregulloren Për Taksa, Tarifa dhe Gjoba Komunale.

Tyrkan Dedinja

Zyrtare për Buxhet dhe Financa

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Komuna e Mitrovicës

Mobil: +386 (0) 43-890-115

E-mail: tyrkan.dedinja@rks-gov.net

Tyrkan Dedinja

From: Adem Fazliu
Sent: Tuesday, March 5, 2024 8:56 AM
To: Tyrkan Dedinja
Cc: Igballe Islami; Florent Abrashi; Dafina Mehmeti
Subject: FW: DRAFT RREGULLORJA PER TAKSA TARIFA DHE GJOBA KOMUNALE
Attachments: Rregullorja Nr. --- Për Plotësim-Ndryshim të Rregullores Nr.02-2019 me shtesa.doc

Përshëndetje;

Fillimisht e përgëzoj komisioni për punën dhe angazhimet e tij në lidhje me hartimin e Ndryshim -Plotësimit të Rregullores Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoba Komunale me nr protokolit 01-020/04-0039368-2/23 te dates 04/25/2023, e posaqërisht juve në cilësin e kryetares së komisionit.

Andaj,në cilësin e Zyrtarit Kryesor Financiar konstatoj se ky plotsim - ndryshim i rregullores, ka implikime buxhetore pozitive për të gjitha tarifatat, taksat dhe gjobat komunale tek të cilat komisioni ka propozuar rritje të vlerës, ndërsa do të ketë implikime negative buxhetore tek të gjitha taksat dhe gjobat komunale, tek të cilat komisioni ka propozuar zbritje të vlerës ose lirim nga pagesa e tarifës, taksës komunale.

Këto implikime do të reflektojnë tek planifikimi i buxhetit komunal, gjegjësisht tek pjesa e të hyrave Vetanake pasi që përveq pjesës së Grantit Qeveritar pjesë tjetër e fondit burimor të buxhetit komunal janë edhe të hyrat vetanake komunale, të cilat duhet të inkasohen gjithnjë duke u mbështetur në Ligjin Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal që do të implementohet përmes Rregullores në fjalë.

Me respekt !

Adem FAZLIU
Zyrtar Kryesor Financiar



Komuna e Mitrovicës

✉ Adem.Fazliu@ks-gov.net
ademfazliu@hotmail.com
Tel: 038/ 200 - 42 - 017
☎ Tel : +381 (0) 28 / 532 -104 ext.161,
Mob : +377 (0) 44 / 173 - 973
+ 386 (0) 49 / 173 - 973

Ky mesazh është konfidencial. Nëse ju keni pranuar këtë mesazh gabimisht, ju lutem na njoftoni me e-mail dhe fshini atë nga sistemi juaj. Ju nuk mund të kopjoni këtë mesazh ose të bëni publik përmbajtjen e tij.

This message is confidential. If you have received it by mistake, please let us know by e-mail reply and delete it from your system; you may not copy this message or disclose its contents to anyone.

Ju lutem keni në konsideratë ambientin dhe paranë publike para se të shtypni këtë email

From: Tyrkan Dedinja <Tyrkan.Dedinja@rks-gov.net>
Sent: Monday, March 4, 2024 2:06 PM
To: Adem Fazliu <Adem.Fazliu@rks-gov.net>; Lulzim Hajra <Lulzim.Hajra@rks-gov.net>; Bekim Sadiku <Bekim.Sadiku@rks-gov.net>; Fitim Rama <fitim.rama@rks-gov.net>

Cc: Igballe Islami <Igballe.Islami@rks-gov.net>; Florent Abrashi <florent.abrashi@rks-gov.net>; Dafina Mehmeti <Dafina.Mehmeti@rks-gov.net>

Subject: DRAFT RREGULLORJA PER TAKSA TARIFA DHE GJOBA KOMUNALE

Të nderuar,

Shpresoj të jeni mirë dhe punët po ju ecin mbarë.

Së pari në emër të grupit punues Ju falenderoj për vlerësimin dhe përgjigjet e juaja lidhur me Draft Rregullorën Për Taksa, Tarifa dhe Gjoba Komunale.

Duke u bazuar në Rregullorën (MAPL) Nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës, Ju lutem nëse ka mundësi sipas Përgjegjësive të juaja të bëni vlerësimin dhe harmonizimin me legjislacionin në fuqi vetëm për pikat e shtuara me vonesë nga drejtoritë në vijim:

1. Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik
2. Drejtoria për Mirëqenje Sociale
3. Drejtoria e Inspeksionit

Te bashkangjitur gjeni Drafte Rregulloren Për Taksa, Tarifa dhe Gjoba Komunale.

Tyrkan Dedinja

Zyrtare për Buxhet dhe Financa

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Komuna e Mitrovicës

Mobil: +386 (0) 43-890-115

E-mail: tyrkan.dedinja@rks-gov.net

Tyrkan Dedinja

From: Fitim Rama
Sent: Tuesday, March 5, 2024 9:46 AM
To: Tyrkan Dedinja
Subject: FW: DRAFT RREGULLORJA PER TAKSA TARIFA DHE GJOBA KOMUNALE
Attachments: Rregullorja Nr. --- Për Plotësim-Ndryshim të Rregullores Nr.02-2019 me shtesa.doc

Ne rregull eshte Tyrkan!

From: Tyrkan Dedinja <Tyrkan.Dedinja@rks-gov.net>
Sent: Monday, March 4, 2024 2:06 PM
To: Adem Fazliu <Adem.Fazliu@rks-gov.net>; Lulzim Hajra <Lulzim.Hajra@rks-gov.net>; Bekim Sadiku <Bekim.Sadiku@rks-gov.net>; Fitim Rama <fitim.rama@rks-gov.net>
Cc: Igballe Islami <Igballe.Islami@rks-gov.net>; Florent Abrashi <florent.abrashi@rks-gov.net>; Dafina Mehmeti <Dafina.Mehmeti@rks-gov.net>
Subject: DRAFT RREGULLORJA PER TAKSA TARIFA DHE GJOBA KOMUNALE

Të nderuar,

Shpresoj të jeni mirë dhe punët po ju ecin mbarë.

Së pari në emër të grupit punues Ju falenderoj për vlerësimin dhe përgjigjet e juaja lidhur me Draft Rregullorën Për Taksa, Tarifa dhe Gjoba Komunale.

Duke u bazuar në Rregullorën (MAPL) Nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës, Ju lutem nëse ka mundësi sipas Përgjegjësive të juaja të bëni vlerësimin dhe harmonizimin me legjislacionin në fuqi vetëm për pikat e shtuara me vonesë nga drejtoritë në vijim:

1. Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik
2. Drejtoria për Mirëqenje Sociale
3. Drejtoria e Inspeksionit

Te bashkangjitur gjeni Drafte Rregulloren Për Taksa, Tarifa dhe Gjoba Komunale.

Tyrkan Dedinja

Zyrtare për Buxhet dhe Financa

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Komuna e Mitrovicës

Mobil: +386 (0) 43-890-115

E-mail: tyrkan.dedinja@rks-gov.net



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës


Nr. 01-020/04-0009038/24 dt. 06.02.2024
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Ligjin Nr. 05/L - 031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe Kërkesën Elektronike të datës 05.02.2024 të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Kryetari i Komunës, sjell këtë:

V E N D I M

(Për ndryshimin e Vendimit Nr. 01-020/04-0039368-2/23, dt. 24.05.2023)

1. **Ndryshohet** neni 5 (pesë), i Vendimit Nr. 01-020/04-0039368-2/23, dt. 24.05.2023, dhe **riformulohet** si në vijim:
 5. Mandati i Komisionit të formuar sipas nenit 1 (një) të këtij Vendimi përfundon pas Hartimit të Draft-Rregullores për Ndryshim-Plotësimin e Rregullores Komunale për Taksa. Tarifa dhe Gjoha Komunale, dhe procedimit të saj për Miratim në Kuvendin e Komunës së Mitrovicës së Jugut.
2. Të gjitha Dispozitat tjera të Vendimit Nr. 01-020/04-0039368-2/23, dt. 24.05.2023, mbesin në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Kryetari i Komunës

Bedri HAMZA
Bedri HAMZA

Shtojcë:


- 1x1 Kërkesa Elektronike e DBF-së e dates 05.02.2024;
- 1x1 Vendimi Nr. 01-020/04-0039368-2/23, dt. 24.05.2023

T'i dorëzohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Lagjore
- 1x1 Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- 1x1 Anetareve të Komisionit
- 1x1 Arkivit



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/04-0039368-2/ dt. 24.05.2023
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, dhe Propozim-Vendimin Nr. 01-020/04-0039368/23, dt. 19.05.2023, të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M

(Për Formimin e Komisionit për Hartimin e Ndryshim-Plotësimit të Rregullores Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoba Komunale)

1. **FORMOHET** Komisioni për Hartimin e Ndryshim-Plotësimit të Rregullores Komunale Nr. 02/2019 për Taksa, Tarifa dhe Gjoba Komunale, në këtë përbërje:
 - 1.1 Tyrkan Dedinja – kryetare (DBF);
 - 1.2 Dafina Mehmeti – anëtare (DGJKP);
 - 1.3 Florent Abrashi – anëtar (DPU).
2. Komisioni është përgjegjës që të bëjë ndryshimin e Rregullores Komunale Nr. 02/2019 për Taksa, Tarifa dhe Gjoba Komunale duke bërë harmonizimin e këtyre ndryshimeve, dhe duke përfshirë kërkesat dhe nevojat e drejtorive komunale në bazë të dispozitave ligjore pozitive në fuqi.
3. Komisioni në fjalë obligohet që pas hartimit të Draft - Rregullores për Ndryshimin e Rregullores së lartcekur të njëjtën ta procedojë në Kuvendin e Komunës për shqyrtim dhe miratim përmes Kryetarit të Komunës.
4. Komisioni punues bazë për punën e tij do të ketë: Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Statutin e Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Rregulloren (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, Rregulloren Komunale Nr. 02/2019 për Taksa, Tarifa dhe Gjoba Komunale, si dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.



- 5 Komisioni i formuar sipas pikës një (1) të këtij Vendimi obligohet që të hartojë Drafti-Rregulloren në afat më së largu brenda 6 (gjashtë) muajsh, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.
- 6 Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryetari i Komunës


Bedri HAMZA



Shtojcë:

Propozim-Vendimi i DBF-së Nr 01-020/04-0039368/23, dt: 19.05.2023

T'i dërgohet:

- 1x1 Kryetari të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Zyrës për Informim
- 1x1 Drejtore për Buxhet dhe Financa
- 1x1 Anëtarëve të Komisionit
- 1x1 Arkivit



Teuta Selmani

From: Igballe Islami
Sent: Monday, February 5, 2024 10:52 AM
To: Lulzim Hajra; Teuta Selmani
Cc: Valon Hetemi; Tyrkan Dedinja; Florent Abrashi; Dafina Mehmeti
Subject: Kërkese per zgjatje te afatit te vendimit
Attachments: Vendimi i komisionit.pdf

Të nderuar,

Bashkëngjitur gjeni vendimin e komisionit për Hartimin e Ndryshim-Plotesim të Rregullores Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoba Komunale.

Ju lutem që të zgjatet afati i vendimit në mënyrë që komisioni të përfundojë hartimin e Draft-Rregullores dhe të njejten ta procesojë për miratim në kuvendin komunal.

Me respekt,

Igballe Islami
Drejtore për Buxhet dhe Financa
Komuna e Mitrovicës
E-mail: igballe.islami@rks-gov.net
Tel: 046 444 411, ext.42012

Tyrkan Dedinja

From: Artan A. Berisha
Sent: Tuesday, October 10, 2023 9:30 AM
To: Tyrkan Dedinja; Drejtoret.Mitrovica
Cc: Bedri Hamza; Igballe Islami; Adem Fazliu; Zenel Citaku
Subject: RE: Kerkese
Attachments: Taksat per sherbimet e Kadastrit.docx

E nderuara Turkane

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë l ka dorzuar ndryshimet e nevojshme në formë fizike dhe elektronike kohë më parë, si do që të jetë po ju përcjellim prapë.

Gjithë të mirat.

From: Tyrkan Dedinja <Tyrkan.Dedinja@rks-gov.net>
Sent: Monday, October 9, 2023 4:00 PM
To: Drejtoret.Mitrovica <Drejtoret.Mitrovica@rks-gov.net>
Cc: Bedri Hamza <bedri.hamza@rks-gov.net>; Igballe Islami <Igballe.Islami@rks-gov.net>; Adem Fazliu <Adem.Fazliu@rks-gov.net>; Zenel Citaku <Zenel.Citaku@rks-gov.net>
Subject: Kerkese

Te nderuar,

Duke u bazuar ne vendimin e kryetarit per Hartimin e Ndryshime -Plotesimt te Rregulores Komunale per Taksa ,Tarifa dhe Gjoba Komunale me nr protokolit 01-020/04-0039368-2/23 te dates 04/25/2023, ne cilesin e kryeteres se komisionit ju drejtohem me kete email me kerkese qe te na dergoni propozimet tuaja per plotesim ndryshime .Bashkangjitur gjeni Rregulloren 02/2019.

Verejtje:

Ju lutem , edhe nese nuk keni kerkesa apo propozime per plotesim - ndryshim te Regullores 02/2019 te na konfirmoni perms e-mailti.

Me respekt!

Tyrkan Dedinja
Zyrtare për Buxhet dhe Financa
Drejtoria per Buxhet dhe Financa
Komuna e Mitrovicëa
Mobil: +386 (0) 43-890-115
E-mail: tyrkan.dedinja@rks-gov.net

Taksat per sherbimet e Kadastrit, Gjeodezise dhe Prones

Taksat per ofrimin e Sherbimeve te Kadastrit, Gjeodezise dhe Prones jane te bazuara ne perputhshmeri me Udhezimin Administrativ Nr. 12/19 per ndarje dhe regjistrim te parcelave dhe Udhezimin Administrativ Nr. 09/2020 per Tarifat e sherbimeve per regjistrimin e te drejtave te prones se paluajtshme.

Nr.	Sherbimet/aktivitetet, Taksat, Tarifat dhe Gjobat	Lartesia e takses
Taksat per ofrimin e sherbimeve gjeodezike		
Nderrimi i kulturave te parcelave		
1	Nderrimi i kultures te nje parcele pa matje gjeodezike	€ 10.00
Tarifat per dhenien e informatave nga Sistemi I Informacioneve Kadastrale te Tokave te Kosoves nga ZKK-te		
2	Vertetim qe personi fizik ose juridik nuk posedon prona	€ 3.00
3	Çertifikata e pronesise (deri ne dhjete faqe shenime te shtypura)	€ 4.00
4	Çertifikata e pronesise (mbi dhjete faqe shenime te shtypura)	€ 20.00
5	Kopja e planit	€ 4.00
6	Kopja ne formatin A3 me ortofoto (bardhe e zi)	€ 4.00
7	Kopja ne formatin A3 me ortofoto (kolor)	€ 5.00
8	Historiati per nje njesi kadastrale	€ 20.00
Tarifat per bazen gjeodezike		
Pikat trigonometrike		
9	Koordinatat Y,X,H, me pershkrim	€ 5.00
Pikat lidhese		
10	Koordinatat Y,X,H, me pershkrim	€ 4.00
Pikat poligonale		
11	Koordinatat Y,X,H, me pershkrim	€ 3.00
Pike e nivelimit		
12	Koordinatat Y,X,H, me pershkrim	€ 5.00
Pikat ne linje		
13	Koordinatat Y,X,H,	€ 2.00
Pikat e detajit		
14	Pikat e detajit Y,X	€ 1.00
Tarifat per te dhenat ne forme digjitale		

15	Parcela ne format digjital (shpfile, dwg, gml, ili) deri ne 1 ha - sipas kerkeses se pales	€	10.00
16	Parcela ne format digjital (shpfile, dwg, gml, ili) mbi 1 ha deri 2 ha - sipas kerkeses se pales	€	20.00
17	Parcela ne format digjital (shpfile, dwg, gml, ili) mbi 2.01 ha deri 5 ha - sipas kerkeses se pales	€	40.00
18	Parcela ne format digjital (shpfile, dwg, gml, ili) mbi 5 ha - sipas kerkeses se pales	€	60.00
19	CD-kompakt disku	€	0.50
Tarifat e sherbimit per nderrimin e kulturave te parcelave			
20	Pergaditja e raportit per nderrimin e kultures se nje parcele pa matje gjeodezike	€	10.00
Tarifat e sherbimit per punet e veçanta gjeodezike			
21	Identifikimi I njesive kadastrale ne zyre	€	10.00
22	Identifikimi I njesive kadastrale ne terren	€	30.00
23	Konsulta profesionale	€	10.00
Regjistrimi i prones, posedimit ne baze te transaksioneve (shitblerjes)			
24	Per vleren e transaksionit deri ne 10,000 €	€	30.00
25	Per vleren e transaksionit prej 10,001 € deri 50,000 €	€	50.00
26	Per vleren e transaksionit prej 50,001 € deri 100,000 €	€	70.00
27	Per vleren e transaksionit prej 100,001 € deri 200,000 €	€	90.00
28	Per vleren e transaksionit prej 200,001 € deri 500,000 €	€	120.00
29	Per vleren e transaksionit prej 500,001 € deri 1,000,000 €	€	240.00
30	Mbi vleren 1,000,000 €, tarifa eshte	€	500.00
31	Per vleren e kontrates -transajtioneve qe eshte e vertetuar para vitit 1999, tarifa eshte	€	50.00
Regjistrimi i pronesise, posedimit ne baze te dokumentit mbi dhuraten			
32	Tarifa per regjistrimin e pronesise sipas kontrates se dhurimit per anetarin e familjes eshte:	€	30.00
33	Tarifa per regjistrimin e pronesise sipas kontrates se dhurimit per personin qe nuk eshte anetar I familjes dhe nuk eshte e caktuar vlere e prones, tarifa eshte:	€	80.00
<i>Tarifa per regjistrimin e pronesise sipas kontrates per dhurimin e prones se paluajtshme, ne te cilen eshte caktuar vlere e prones dhe dhuratemarres nuk eshte anetar i familjes zbatohet tarifa sipas nenit 5 te Udhezimit Administrativ me nr. 09/2020 per Tarifat e sherbimeve per regjistrimin e te drejtave te prones se paluajtshme:</i>			
34	Per vleren e dhurates deri 10,000 €	€	30.00
35	Per vleren e dhurates prej 10,001 € deri 50,000 €	€	50.00
36	Per vleren e dhurates prej 50,001 € deri 100,000 €	€	70.00
37	Per vleren e dhurates prej 100,001 € deri 200,000 €	€	90.00
38	Per vleren e dhurates prej 200,001 € deri 500,000 €	€	120.00
39	Per vleren e dhurates prej 500,001 € deri 1,000,000 €	€	240.00
40	Mbi vleren e 1,000,000 €	€	500.00

Tarifa e regjistrimit te pronesise, ne baze te kontrates mbi mbajtjen e perjetshme		
41	Tarifa per regjistrimin e pronesise sipas kontrates se mbajtjes se perjetshme per personin qe eshte anetari I familjes eshte 30 (euro) per çdo pronar	€ 30.00
42	Tarifa per regjistrimin e pronesise sipas kontrates se mbajtjes e perjetshme per personin qe nuk eshte anetar I familjes dhe nuk eshte e caktuar vlera prones tarifa eshte:	€ 80.00
	<i>Tarifa per regjistrimin e pronesise sipas kontrates per mbajtjen e perjetshme, ne te cilen eshte caktuar vlera e prones dhe mbajtes nuk eshte anetar I familjes zbatohet tarifa sipas nenit 5 te Udhezimit Administrativ me nr. 09/2020 per Tarifat e sherbimeve per regjistrimin e te drejtave te prones se paluajtshme:</i>	
43	Per vleren e dhurates deri 10,000 €	€ 30.00
44	Per vleren e dhurates prej 10,001 € deri 50,000 €	€ 50.00
45	Per vleren e dhurates prej 50,001 € deri 100,000 €	€ 70.00
46	Per vleren e dhurates prej 100,001 € deri 200,000 €	€ 90.00
47	Per vleren e dhurates prej 200,001 € deri 500,000 €	€ 120.00
48	Per vleren e dhurates prej 500,001 € deri 1,000,000 €	€ 240.00
49	Mbi vleren e 1,000,000 €	€ 500.00
	Tarifa e regjistrimit te pronesise apo te drejtave sendore ne baze te titullit juridik te organeve administrative dhe gjyqesore	
50	Tarifa per regjistrimin e te drejtes se pronesise mbi pronen e paluajtshme apo te drejtave tjera sendore ne baze te vendimit te organit administrativ apo gjyqesor eshte (30) euro per çdo pronar	€ 30.00
	Tarifa per regjistrimin e bashkepronese apo pronesise se perbashket	
51	Tarifa per regjistrimin e te drejtes ne bashkepronesi apo pronesi te perbashket per bashkepronarin apo pronarin e perbashket eshte:	€ 30.00
52	Tarifa per regjistrimin e te drejtes ne pronesi te perbashket per bashkeshortet eshte (30) euro per nje titull juridik	€ 30.00
	Tarifa per regjistrimin e njesive kadastrale (Parcel, Objekt)	
53	Tarifa per regjistrimin e njesise kadastrale te krijuar nga ndarja apo bashkimi eshte:	€ 20.00
54	Tarifa per regjistrimin e njesise kadastrale si pjese e nderteses eshte (25) euro per njesi	€ 25.00
	Tarifa e regjistrimit te ndarjes se bashkepronese apo pronesise se perbashket	
55	Tarifa per regjistrimin e pronesise ne baze te ndarjes nga bashkepronesia apo pronesia e perbashket per secilin bashkepronar qe behet pronar individual eshte (30) euro	€ 30.00
	Tarifa e regjistrimit te pronesise ne baze te trashegimise dhe te shkeputjes se bashkesise familjare	
56	Tarifa per çdo trashegimtar per regjistrimin e pronesise ne baze te trashegimise eshte;	€ 10.00

57	Tarifa per çdo trashëgimtar per regjistrimin e pronesise ne baze te trashëgimise, e cila rrjedh nga testamenti eshte:	€	20.00
58	Tarifa per regjistrimin e pronesise ne baze te shkeputjes se bashkesise familjare per çdo anetar te familjes qe behet pronar eshte:	€	20.00
59	Tarifat e regjistrimit te pronesise ne baze te nderrimit/kembimit te prones se paluajtshme		
60	Tarifa per regjistrimin e pronesise ne baze te nderrimit-kembimit te prones se paluajtshme per secilin pronar eshte:	€	40.00
	Tarifa per regjistrimin e te drejtes se shfrytezimit - qirambajtja		
61	Tarifa per regjistrimin e te drejtes se shfrytezimit - qirambajtjes per çdo njesi kadastrale, kur pronar eshte Qeveria apo Komuna, me kohezgjatje deri ne 10 vite eshte:	€	10.00
62	Tarifa per regjistrimin e te drejtes se shfrytezimit - qirambajtjes per çdo njesi kadastrale, kur pronar eshte Qeveria spo Komuna, me kohezgjatje prej (10) vite deri ne (40) vite eshte:	€	30.00
63	Tarifa per regjistrimin e te drejtes se shfrytezimit - qirambajtjes per çdo njesi kadastrale, kur pronar eshte Qeveria apo Komuna, me kohezgjatje prej (40) vite deri ne (99) vite eshte:	€	50.00
64	Tarifa per regjistrimin e qirase nga personi fizik apo juridik ne kohezgjatje deri ne (10) vite per çdo njesi kadastrale eshte:	€	10.00
65	Tarifa per regjistrimin e qirase nga personi fizik apo juridik ne kohezgjatje mbi (10) vite per çdo njesi kadastrale eshte:	€	20.00
66	Regjistrimi I te drejtes se shfrytezimit - Qirambajtjes per pronat e privatizuara nga ish Ndermarrjes Shoqerore, me kohezgjatje prej (99) vite, behet duke zbatuar tarifen e percaktuar sipas nenit 5 te udhezimit administrativ Nr.09/2020 per tarifat e sherbimeve per regjistrimin e te drejtave te prones se paluajtshme.		
	Tarifa per regjistrimin e Hipotekes		
	Tarifa per regjistrimin e hipotekes sipas vleres se kredise te percaktuar me dokumentin e hipotekes eshte:		
67	deri ne (30,000) euro	€	20.00
68	Prej (30,001) euro deri ne (50,000)	€	30.00
69	Prej (50,001) euro deri ne (100,000)	€	60.00
70	Prej (100,001) euro deri ne (200,000)	€	90.00
71	Prej (200,001) euro deri ne (500,000)	€	120.00
72	Prej (500,001) euro deri ne (1,000,000)	€	240.00
73	mbi vleren (1,000,000)	€	400.00
74	Hipoteka e cila regjistrohet ne dy apo me shume ZKK, tarifa perpjestohet ne menyre te barabarte		
	Tarifa per modifikimin dhe fshirjen e hipotekes		
75	Tarifa per modifikimin e hipotekes se regjistruar eshte:	€	10.00

Tarifa per regjistrimin, modifikimin dhe fshirjen e servitutit		
76	Tarifa per regjistrimin e te drejtes se servitutit per secilen parcele dominante apo person eshte :	€ 30.00
77	Tarifa per modifikimin e servitutit eshte:	€ 10.00
78	Tarifa per fshirjen e servitutit nga Regjistri eshte:	€ 20.00
Tarifa per regjistrimin, modifikimin dhe fshirjen e barrave dhe ngarkesave tjera		
80	Tarifa per regjistrimin e barres ne tatimin ne pronen e paluajtshme eshte:	€ 20.00
81	Tarifa per regjistrimin e verejtjes sipas Ligjit per Regjistrin e te Drejtave te Prones se Paluajtshme eshte:	€ 40.00
82	Tarifa per regjistrimin e ndaleses nga Permbaruesi Privat apo Gjykata ne procedure permbarimore per secilen njesi kadastrale eshte;	€ 30.00
83	Tarifa per regjistrimin e verejtjes te mbajtesit ne pronen e paluajtshme te te mbajturit ne momentin e lidhjes se Kontrates mbi mbajtjen e perjetshme eshte:	€ 20.00
84	Tarifa per modifikimin e barres apo ngarkeses tjeter eshte:	€ 10.00
Tarifa per korigjimin e te dhenave kadastrale		
85	Tarifa per korigjimin e te dhenave kadastrale qe konstatohet se jane regjistruar gabim si pasoje e dokumentacionit te dorezuar nga palet eshte:	€ 30.00
Takse per shfrytezimin e parceles komunale		
86	Zona 1 - per m ²	€ 3.00
87	Zona 2 - per m ²	€ 2.00
88	Zona 3 - per m ²	€ 1.50
89	Zona 4 - per m ²	€ 1.00



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE INFRASTRUKTURË

DATË/A:	08. 02. 2024
REFERENC-Ë:	02-434/01-0010309 /24
PËR/ZA/TO:	Komitetin për Politikë e Financa Kuvendin e Komunës
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z.Bedri HAMZA Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	z.Granit TMAVA Drejtor i DSHPI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozim për Ndryshim -Plotësimin e Rregullorës Komunale Nr.02/2019- Për Taksat,Tarifat dhe Gjobat Komunale

Bazuar në nenin 12 pika”c” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L40;nenit12 të Statutit të Komunës ,DSHPI i propozon Kryetarit të Komunës ,Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës këtë:

**Propozim Për Ndryshim -Plotësimin e Rregullorës Komunale Nr.02/2019
Për Taksat ,Tarifat dhe Gjobat Komunale**

I propozohet Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës që të aprovojë ,Plotësimin e Rregullorës Komunale Nr.02/2019 Për Taksat ,Tarifat dhe Gjobat Komunale si në vijim:

**Neni 10
Tarifa për Automjete Transportuese**

Tabela Nr.7

Nr.	Për bartjen e Automjeteve me Automerimang	Taksa
a).	Automjetet	20.00 €
b)	Mini-bus,xhipat	25.00 €
c)	Kamionat)-autobusët	30.00 €

1.	Kompenzimi mujor për një vendkalim të automjeteve për operator taxi(radio-taxi)për 5 veturax20.00€në muaj për vendparkim që shfrytëzohet	100.00 €
2.	Kompenzimi mujor për një vendkalim të automjeteve për operator Taxi	15.00€

	individual –në muaj	
3.	Vazhdimi i vijave ,vërtetimit të orarit të nisjeve të rrendeve të udhëtimit të udhëtarëve (autobus)në relacione urbane dhe urbane periferike për një vit kalendarik.	100.00 €
	Operatori Taxi nuk mund të shfrytëzojë më shumë se dy vendkalime të lejuara për automjete.	
5.	Licenca për taxi individual	30€
6.	Licenca për auto-transportues (Radio Taxi)	50€
7.	Licenca për kompanitë për transportin e udhëtarëve (Kjo Licencë lëshohet për afatin 5 vjeçar)	300€
	(Taksa për Licenca është përcaktuar sipas Udhëzimit Administrativ Nr.07/2015-Për Licencimin e operatorëve të transportit rrugor të udhëtarëve) të dt.17.12.2015.	

Tabela Nr. 8 - Taksa komunale për qëndrimin e veturave të përjashtuara nga komunikacioni në parkingun e komunës së veturave

Nr.	Kategoria	Taksa
1.	Automjetet, motoçikletë dhe traktor – në ditë	1.5 €
2.	Mjetet tjera deri në tre tonë e gjysmë (3.5 t) - në ditë	3 €
3.	Mjetet mbi tre tonë e gjysmë (3.5 t) - në ditë	5 €

Tabela Nr.9 - Taksa komunale mujore për parkimin e automjeteve

Nr.	Kategoritë	Taksa
A) PARIK MUJOR		
1.	Për personat juridik në Zonën I – në muaj	90 €
2.	Për personat fizik në Zonën I – në muaj	90 €
3.	Për personat juridik në Zonën II – në muaj	45€
4.	Për personat fizik në Zonën II – në muaj	45 €
5.	Për personat juridik në Zonën III – në muaj	30 €
6.	Për personat fizik në Zonën III	30 €
7.	Parkim të përkohshëm për qëllim të ngarkimit apo shkarkimit të mallrave-ne muaj	20 €
B) PARKIM I PËRKOHSHËM		
	Për personat juridik në Zonën I - në orë	3 €
	Për personat fizik në Zonën I – në orë;	3 €
	Për personat juridik në Zonën II – në orë;	1.50 €
	Për personat fizik në Zonën II – në orë;	1.50 €
	Për personat juridik në Zonën III – në orë	1 €
	Për personat fizik në Zonën III – në orë	0.20 €
	*Të gjitha Taksat komunale për parkim të automjeteve për shfrytëzim të hapësirave publike brenda territorit të Komunës së Mitrovicës janë të bazuara në Planin e Mobilitetit të Qëndrueshëm të Komunës së Mitrovicës i aprovuar nga Kuvendi Komunal në vitin 2020.	

Tabela Nr. 10 - Taksa komunale për bllokimin e rrugëve primare dhe sekondare

Nr.	Kategoria	Taksa
1.	Bllokimi i rrugës primare nga personat fizik deri në gjashtë (6) orë	50 €
2.	Bllokimi i rrugës primare nga personat fizik nga gjashtë (6) deri në dymbëdhjetë (12) orë	50 €
3.	Bllokimi i rrugës sekondare nga personat fizik nga gjashtë (6) deri në dymbëdhjetë (12) orë	30 €
4.	Bllokimi i rrugës sekondare nga personat fizik nga gjashtë (6) – orë për çdo ditë;	30 €

Tabela Nr. 11

Nr.	Kategoria	Taksa
1.	Për 1m ² dëmtim të asfaltit	30.00€
2.	Për 1 m ² dëmtim të kubëzave të betonit	20.00€
3.	Për 1m ² dëmtim të rrugëve me zhavor	10.00€
4.	Për dëmtim të trotuarit (hapjen e kanaleve në trotuar në m ²	20.00€
